



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Mësuesi për Arsimin Fillor”

ofruar nga

Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Gezim Dibra

Prof.As. Nada Kallçi

Qershor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në: Mësuesi për Arsimin Fillor**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr.426, date 14.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 194, datë 16.07.2024
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022-2023 18 PAE / 4 PAK; Viti akademik 2023-2024 18 PAE / 5 PAK; Viti akademik 2024-2025 18 PAE / 4 PAK;
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023 10 studentë; Viti akademik 2023-2024 14 studentë; Viti akademik 2024-2025 10 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm u realizua duke u mbështetur në dy elemente kryesorë, si: Shqyrtimi dhe analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit “Fan Noli” të Korçës (në vijim UNIKO) dhe së dyti sipas veprimtarive të realizuara konform agjendës së miratuar nga dy institucionet ASCAL dhe UNIKO. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet e evidentuara nga analiza e procesit të vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të parë me emërtesë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”. Programi i studimit sipas Urdhërit të MAS Nr.426, datë 14.07.2022, është riorganizuar nga Bsc në “Mësuesi për arsimin Fillor Kl I-VI” në Bsc. “Mësuesi për arsimin fillor”. Programi ofrohet prej Departamenti të Edukimit (DE) pjesë e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë në UNIKO-së.

Aktualisht, programi Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program synon të përgatisë profesionistë të Arsimit Fillorë për tregun e punës brenda dhe jashtë vendit me shprehje të veçanta që mundësojnë një rol të shumëfishtë të mësuesit duke mundësuar hapin e parë drejt profesionit të mësuesit në institucionet arsimore publike dhe private.

Ai përmban gjithsej 180 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 3 vite akademike / 6 semestra. Në përfundim të ciklit të studimit tre vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare Bachelor “Mësuesi për Arsimin Fillor”. Forma e regjistrimit të diplomës: Urdhër i QSHA nr.194, datë 16.07.2024. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program në tre vite është:

- Për vitin akademik 2024-2025 është 10 studentë;
- Për vitin akademik 2023-2024 është 14 studentë;
- Për vitin akademik 2022-2023 është 10 studentë;

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor “Mësuesi për Arsimin Fillor” nuk ka kaluar më parë proces akreditimi. Ky program studimi akreditohet për herë të parë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, nga ana e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Mësuesi për Arsimin Fillor”. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga **Prof. Dr Gëzim Dibra** dhe **Prof.Asoc. Nada Kallçiu** dhe gjatë vizitës në institucion ky grup pune u asistua dhe nga kordinatorja teknike e ASCAL-it, Znj. Majlinda Demirneli. Vizitat u realizuan në datat 5 dhe 6 Mars 2025. Për përmbushjen me sukses të këtij vlerësimi të jashtëm, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije nga ekspertja e ASACL.

Dokumentacioni ligjor mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, të UNIKO-së, është:

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 5 datë 07.01.1992 “Për Vendimin e hapjes së Universitetit të Korcës “Fan Noli”
- *Urdhër MAS Nr. 426, datë 14.07.2022, për licencimin e Programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” si program i ciklit të parë i studimeve bachelor në Universitetin “Fan Noli” Korçë.*
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.
- VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
- VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018”.
- Statutin e UNIKO-s dhe Rregulloret në UNIKO.
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

Aktivitetet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete duke përfshirë analizën e të dhënave parësore dhe dytësore si dhe vizitat në ambjentet e brendshme të UNIKO-s dhe në Fakultetin të Edukimit dhe Filologjisë -së.

Analiza e të dhënave parësore është bazuar nga të dhënat e marra nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe evidencat përkatëse për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor “ Mësuesi për Arsimin Fillor (Janar 2025), i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit.

Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Drejtues te institucionit që mbulojnë programin e studimit;
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm;
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program;
- Takim me studentë të këtij programi;

- Takim me përfaqësues të Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë dhe të Kërkimit shkencor.
- Takim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit; Koordinatorin e projekteve Erasmus +.
- Vizitë në Sekretarinë mësimore
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe i bibliotekës

Qëllimi i këtyre takimeve ishte realizmi i bisedave që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm. Pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, ishte edhe:

Vëzhgimi i mjediseve mësimore në dispozicion të programit të studimit nga ekipi i vlerësuesve të jashtëm, si: auditorë, laboratorë të arteve, të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve të bibliotekës së FEF-së dhe të UNIKO-së. Mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB si dhe nga evidencat përkatëse, është hartuar ky raport i vlerësimit të jashtëm.

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.05.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 36/56 Prot, datë 12.05.2025. Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, njofton në ASCAL në datë 23.05.2025, nëpërmjet shkresës me Nr. 1055/1, Prot, datë 21.05.2025, “Dërgohen komentet për draft raportet e vlerësimit të jashtëm Bachelor në mësuesi në arsim parashkollr dhe Bsc në mësuesi në arsim fillor, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga UNIKO, rezulton se Programi i Studimit Bachelor “Mësuesi për Arsimin Fillor” është i harmonizuar me prioritetet kombëtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe me objektivat dhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë” dhe aktet përkatëse nënligjore. Ky program synon të rrisë cilësinë e procesit mësimor në arsimin fillor, të aftësojë studentët për tregun e punës dhe të zhvillojë kompetenca që kontribuojnë në shërbim të komunitetit lokal dhe më gjerë. Në përputhje me objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2022–2027, ky program ka si qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, si dhe pasurimin dhe promovimin e saj përmes veprimtarive që nxisin zhvillimin akademik të studentëve.¹
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i Statutit dhe i Planit Strategjik të Zhvillimit 2022–2027 të institucionit, konstatohet se Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është i përafshuar me qëllimet strategjike dhe misionin institucional.² Kjo përputhje pasqyrohet edhe në Rregulloren për Organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore të FEF. Programi synon përgatitjen e specialistëve të pajisur me kompetenca thelbësore praktike, funksionale dhe komunikuese, me qëllimin kryesor të kontributit në zhvillimin rajonal dhe më gjerë.³
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat	Konstatohet se Programi i Studimit Bachelor “Mësuesi për Arsimin Fillor” është në përputhje me qëllimet strategjike të UNIKO-s, të pasqyruara në statutin e institucionit. Evidentohet gjithashtu se ky program është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UNIKO-s, duke synuar përgatitjen e specialistëve në fushën e arsimit fillor. Formimi i studentëve realizohet përmes një

¹ “Plani strategjik i zhvillimit të Universitetit 2022-2027”. Referuar evidencës nr. 1.3

² “Statuti i Universitetit të Korçës”. Referuar evidencës nr.1.1

³ “Rregullore e Organizimit dhe veprimtarisë mësimore e shkencore e FEF”. Referuar evidencës nr.1.5

e drejtimet akademike të tij.	kombinimi të balancuar të njohurive teorike dhe përvojës praktike, të mbështetura në lëndë të përgjithshme dhe profesionale, si dhe në praktika pasive dhe aktive të zhvilluara në shkolla. ⁴																					
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, si edhe nga vizita dhe takimet në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), evidentohet se Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ofrohet nga Departamenti i Edukimit, një njësi bazë brenda Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë. Ky departament disponon përvojë të konsoliduar, kapacitete të nevojshme dhe burime të përshtatshme në fushën përkatëse akademike për realizimin e programit.⁵ Departamenti i Edukimit për vitin akademik 2024 – 2025 ka në përbërje të tij, 12 anëtarë të personelit akademik efektiv (PAE), dhe 16 personel akademik me kontratë (PAK), me kualifikimet si më poshtë: <table><tr><th>Kualifikimi</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>1</td><td>5</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>3</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>5</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr. në proces</td><td>3</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>3</td><td>8</td></tr><tr><td>Totali</td><td>12</td><td>16</td></tr></table> Konstatohet se Departamenti i Edukimit ka një eksperiencë të qëndrueshme disa vjeçare në ofrimin e këtij programi dhe përmbush standardet sasiore dhe cilësore për sa i përket përbërjes së stafit akademik, çka mundëson zbatimin efektiv të tij. Gjithashtu, vihet re se stafi akademik me kohë të plotë dhe ai me kohë të pjesshme kanë përgatitje të përshtatshme akademike dhe shkencore, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Po ashtu, respektohet balanca dhe raporti i përcaktuar ndërmjet stafit me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme.⁶	Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	1	5	Prof. Asoc.	-	3	Dr./PhD	5	-	Dr. në proces	3	-	Msc.	3	8	Totali	12	16
Kualifikimi	PAE	PAK																				
Prof. Dr.	1	5																				
Prof. Asoc.	-	3																				
Dr./PhD	5	-																				
Dr. në proces	3	-																				
Msc.	3	8																				
Totali	12	16																				
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën	Rezulton se Programi i Studimit është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit, si dhe me strategjinë përkatëse të njësisë bazë. Fushat e studimit të këtij programi janë të lidhura ngushtë me drejtimet kryesore të kërkimit shkencor të ndjekura nga UNIKO.																					

⁴ “Statuti I Universitetit të Korçes”. Referuar evidencës nr.1.1; “Plani strategjik i zhvillimit të Univeritetit 2022-2027”. Referuar evidencës nr. 1.3

⁵ “Stafi Akademik I DE” Tabela përmbledhëse Aneks (Tabela 1; 2.)

⁶ “Jetshkrimet e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit” Referuar evidencës nr.2.14

akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Rregullorja mësimore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ⁷ , e ofruar nga Departamenti i Edukimit, mbështetet në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, si dhe në Udhëzimin e MASR nr. 31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”. ⁸			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e dokumentacionit të dorëzuar si dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), në lidhje me kriteret për Standardin I.1, vëren se Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është në përputhje me qëllimet dhe prioritetet kombëtare.</i> <i>Ky program, i ofruar nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF) dhe Departamenti i Edukimit (DE), mbështetet në një përvojë shumëvjeçare dhe disponon kapacitete të kualifikuara dhe të mjaftueshme për zbatimin e tij në mënyrë efektive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL), si dhe nga takimet e zhvilluara në institucion, konstatohet se Departamenti i Edukimit, në kuadër të zbatimit të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi ndërdepartamentale brenda fakultetit, përfshirë edhe bashkëpunimin me Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Humane. Ky bashkëpunim synon të mundësojë realizimin sa më të plotë të kompetencave të përcaktuara në programin e studimit. Zbatimi i këtij bashkëpunimi është formalizuar nëpërmjet Rregullores së programit, ⁹ ndërsa funksionimi dhe

⁷ Rregullore e brendëshme e DE” Referuar evidencës nr. 2.4

⁸ Udhëzimi i MASR nr.31 datë 29.12.2017

⁹ Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” Evidenca nr.2.4

punës së tyre.	rezultatet e tij pasqyrohen në analizat vjetore të Departamentit të Edukimit dhe të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (FEF). ¹⁰
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Konstatohet se Departamenti i Edukimit ka ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, me institucione të ndryshme, ndër të cilat përmenden: Departamenti i Shkencave të Edukimit në Universitetin e Bolonjës, Programi TEAVET për zhvillimin profesional të mësuesve, Zyra Vendore e Arsimit (ZVA), si dhe Bashkia Korçë. ¹¹ Vlerësohet si praktikë pozitive ajo e ndjekur nga Departamenti i Edukimit dhe Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF), në lidhje me analizimin dhe hartimin e raporteve mbi përfitimet e sjella nga këto bashkëpunime, si dhe identifikimin e mundësive për përshtatje dhe përmirësim të mëtejshëm të programeve të studimit. ¹²
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe evidencave të paraqitura nga institucioni, evidentohet se Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) ka mbi 50 marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si Akademia e Shkencave, ministri, agjenci shtetërore dhe institucione kërkimore, të gjitha në funksion të mbështetjes dhe realizimit të programeve të studimit. ¹³ Gjithashtu, rezulton se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF) ka nënshkruar marrëveshje specifike bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale me Bashkitë Korçë, Devoll, Kolonjë, Pogradec etj, si dhe me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Korçë. ¹⁴
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga bisedat e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, evidentohet se praktikat profesionale udhëhiqen nga pedagogu mentor, në përputhje me objektivat e përcaktuara të programit të studimit. Pas përfundimit të praktikës, realizohet një analizë vlerësuese, e cila përfshihet në analizat vjetore të Fakultetit dhe të Departamentit përkatës. ¹⁵ <i>Sugjerojmë që për këto praktika, të hartohet edhe një program i veçantë lënde, i cili duhet të përgatitet nga pedagogët udhëheqës të praktikës profesionale, për të siguruar një strukturim më të qartë dhe koherent të procesit mësimor-praktik.</i>
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të Standardit I.2, si dhe në gjetjet e evidentuara nga</i>

¹⁰ "Analizë e punës mësimore shkencore e DE dhe FEF-së. Evidenca nr. 2.9 dhe 2.10

¹¹ "Lista përmbledhëse e marrëveshjeve ndërkombëtare" Evidenca Nr.3.10 ; "Tabela përmbledhëse për anekset" (tabela nr.5)

¹² "Procesverbal I DE për ecurinë e programeve të studimit" Evidenca nr. 3.9

¹³ "Lista përmbledhëse e marrëveshjeve ndërkombëtare" Evidenca Nr.3.10; "Tabela përmbledhëse për anekset" (tabela nr.5)

¹⁴ " Marrëveshje bashkëpunimi në funksion të praktikës profesionale".Evidenca nr.3.12

¹⁵ "Raport I analizës vjetore të punës mësimore shkencore të DE" Evidenca nr.2.10

	<i>dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), konstaton se Departamenti përgjegjës për programin ka zhvilluar një kulturë të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione dhe projekte të ndryshme, të cilat mbështesin formimin akademik dhe praktik të studentëve.</i> <i>Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit. Rregulloret e Institucionit, njësisë kryesore dhe të organeve të tjera rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave brenda institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Rezulton se Programi i Studimit Bachelor në “Mësues për Arsimin Fillor” është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në veçanti me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me aktet nënligjore përkatëse, përfshirë Udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2017 “Për riorganizimin e programeve të studimit”¹⁶ dhe me orientimet e përcaktuara në Kartën e Bolonjës. Programi zbatohet në përputhje me Rregulloren e tij¹⁷ dhe është i strukturuar në lëndë dhe module, të cilat pasqyrohen në Planin Mësimor. Për secilën njësi mësimore jepen në mënyrë të detajuar

¹⁶ MARS Udhëzim nr.31, datë. 29.12.2017 për Riorganizimin e Programeve të Studimit.

¹⁷ “Rregullore e programit të studimit. Evidenca nr. 2.4

	kreditet sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)¹⁸, si dhe të dhëna të tjera përkatëse, si tipologjia e lëndës, semestri apo viti akademik në të cilin zhvillohet, si dhe ngarkesa semestrale.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ka si qëllim kryesor përgatitjen profesionale të mësuesve për arsimin fillor, duke i pajisur studentët me diplomën përkatëse në këtë profil. Programi synon të sigurojë një formim të integruar teorik dhe praktik në fushën e mësimdhënies, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së edukimit dhe në përmirësimin e standardeve profesionale të mësuesit të arsimit fillor. Njëkohësisht, programi angazhohet të bashkëpunojë me institucionet përkatëse arsimore, duke ofruar mbështetje për zhvillimin e mëtejshëm të praktikës në këtë nivel arsimor.¹⁹ Analiza e planit mësimor dhe e syllabuseve të programit tregon se përmbajtja e kurseve i pajis studentët me njohuri dhe kompetenca profesionale në fushat kryesore të profilit, duke u mundësuar atyre që në përfundim të studimeve të jenë të aftë të ushtrojnë profesionin në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme.²⁰ <i>Megjithatë, nga vëzhgimi i thelluar i lëndëve të kurrikulës, vihet re se disa prej tyre përmbajnë koncepte ose trajtojnë tema që nuk janë plotësisht në përputhje me emërtimin e programit apo me nivelin e arsimit fillor (p.sh. “Mesimdhënia dhe te nxenit me teknologji te reja”; “Aftësim teknologjik praktik).</i> <i>Në këtë drejtim, <u>GVJ rekomandon</u> që disa nga lëndët sidomos ato të përbashkëta (me programin në arsimin parashkollor) të ristrukturohen dhe të përshtaten më mirë me specifikat e mësimdhënies në ciklin fillor, në mënyrë që të sigurojnë përputhshmëri të plotë me objektivat e programit.²¹</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga analiza e Programit të Studimit rezulton se kurrikula është në përputhje me kërkesat ligjore që rregullojnë ndërtimin e planit mësimor. Përkatësisht, ndarja e krediteve sipas kategorive respektive është si më poshtë: - Kategoria A (Lëndët Bazë): 34 kredite, që përfaqësojnë 18.9% të totalit të krediteve, duke përmbushur kriterin prej 15%–20%; - Kategoria B (Lëndët Karakterizuese): 97 kredite ose 53.8%, në përputhje me kufirin e kërkuar prej 50%–55%; - Kategoria C (Lëndët Ndërdisciplinore/Integruese): 22 kredite, që përbëjnë 12.2%, brenda intervalit të përcaktuar prej 12%–15%;

¹⁸ “Plani mësimor i programit bachelor në “Mësuesi për arsimin fillor” Evidenca nr. 2.5

¹⁹ “Rregullore e programit të studimit AF”.Evidenca nr.2.4

²⁰ “Plani mësimorë i programit”.Evidenca nr.2.6

²¹ “Programet lëndore model syllabusi 2024-2027” Evidenca nr.2.12

	- Kategoria D (Lëndët Plotësuese): 21 kredite ose 11.7%, në përputhje me kërkesën prej 10%–15%; - Kategoria E (Detyrimet Përmbyllëse): 6 kredite ose 3.3%, duke respektuar kufirin ligjor prej 3%–5%; Në përfundim, konstatohet se kurrikula e këtij programi është ndërtuar në përputhje me standardet e përcaktuara, duke respektuar përqindjet e kërkuara për secilën kategori lëndësh dhe duke siguruar që çdo lëndë apo modul të zërë vendin e duhur në kuadër të veprimtarive formuese të programit.^{22/23}
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit kurrikular të Programit të Studimit rezulton se ky i fundit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale, e cila zë një peshtë specifike prej 7 ECTS, përkatësisht 175 orë. Studentët angazhohen në praktikë pranë institucioneve arsimore të përzgjedhura, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet UNIKO-s dhe Zyrës Vendore Arsimore Korçë, si dhe me bashkitë Korçë, Devoll, Pogradec, etj. <i>Megjithatë, vihet re se <u>mungon</u> një program i detajuar i praktikës profesionale i hartuar nga pedagogët udhëheqës, i cili do të siguronte më shumë qartësi dhe strukturë në realizimin e kësaj përvoje formuese.</i> Praktika zhvillohet zakonisht gjatë semestrit të gjashtë dhe studentët vlerësohen nga mësuesit mentorë në institucionet pritëse publike ku kryhet praktika.²⁴ Ndërkohë, në “Rregulloren për organizimin dhe veprimtarinë mësimore-shkencore të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë”, konkretisht në <i>nenin 95</i> të titulluar “Diplomimi”, janë përcaktuar në mënyrë të qartë procedurat që studentët duhet të ndjekin për mbrojtjen e diplomës.²⁵
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë	Nga analiza e kurrikulës së Programit të Studimit rezulton se ajo është ndërtuar në përputhje të plotë me vendimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), që lidhen me funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë, si dhe me Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore-shkencore të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (FEF).²⁶ Në përfundim të çdo viti akademik, njësia bazë miraton kuotat për pranimin e studentëve, duke përfshirë kategoritë: studentë nga vendi, studentë në program të dytë studimi, transferime studimesh, shtetas të huaj, studentë me status jetimi, persona me aftësi të kufizuara, si dhe individë që i përkasin komuniteteve rom dhe egjiptian. Gjithashtu, përfshihen

²² “Tabela përmbledhëse në anekset” Tabela nr.9

²³ “Plan i mësimor 2024-25 i programit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor.Evidenca nr.2.6

²⁴ “Formular vlerësimi I praktikës profesionale” Evidenca nr. 2.35

²⁵ “Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF-së”neni 95. Evidenca nr.2.1

²⁶ Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF-së” Evidenca nr.2.1.

përgjegjëse për arsimin.	edhe studentë që vijnë nga familje me ndihmë ekonomike apo me prindër me status invaliditeti. Këto kuota i paraqiten për miratim Senatit Akademik nga Dekanati dhe më pas bëhet publikimi i tyre në faqen zyrtare të UNIKO-s. Këto procedura janë të parashikuara në Statutin e Institucionit, konkretisht në nenet 4, 51, 55, 66 dhe 72. ²⁷
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga analiza e planit mësimor të programit, si dhe nga diskutimet me stafin e Departamentit, konstatohet se Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, i ofruar për herë të parë gjatë vitit akademik 1995–1996, ka kaluar nëpër disa faza zhvillimi dhe përmirësimi ndër vite. Në krahasim me kurrikulën fillestare, programi aktual reflekton një sërë ndryshimesh që pasqyrojnë përmirësimin e përmbajtjes dhe përafrimin me standardet bashkëkohore të arsimit. Analiza e veprimtarive formuese të përfshira në programet e lëndëve tregon se ato janë në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit dhe, në një përqindje prej rreth 70%, përkohë me përmbajtjen e programeve të ngjashme të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë në vend.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Nga verifikimi i kryer në bazë të evidencave të paraqitura, si dhe nga vizita në institucion, rezulton se Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është në përputhje me fushën përkatëse të studimit dhe me klasifikimet kombëtare, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” dhe direktivat evropiane në fuqi. Megjithatë institucioni ka ndjekur të gjitha procedurat e përcaktuara për kodifikimin dhe klasifikimin e programeve sipas VKM nr. 310, datë 11.05.2022, dhe ka realizuar kodifikimin e syllabuseve, vihet re se programi nuk ka ende një kod të qartë të reflektuar në dokumentacionin përfundimtar, ndonëse në evidencën 3.27 është përmendur kodi 63 BA0112S . ²⁸
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Konstatohet se ky program studimi ofrohet ekskluzivisht nga Departamenti i Edukimit, në kuadër të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë pranë UNIKO-s, dhe nuk përbën një program të përbashkët me njësi të tjera akademike apo institucione të tjera të arsimit të lartë.
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–8 të Standardit II.1, si dhe në gjetjet e evidentuara nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), vlerëson se Programi i Studimit përmbush në mënyrë të plotë kriteret ligjore për ndërtimin</i>

²⁷ Statuti i UNIKO-së” Evidenca nr.1.1

²⁸ “Praktika të kodifikimit të programeve të studimit” Evidenca nr.3.27

	dhe zbatimin e kurrikulës. Programi ofron formim akademik dhe praktik të nevojshëm për profilin në fjalë, ndërsa plani mësimor, përmes lëndëve bazë, lëndëve të formimit profesional, atyre me zgjedhje dhe detyrimeve përmbyllëse, është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, përmbajtja e programit paraqet përputhje dhe ngjashmëri me programe të ngjashme të ofruara nga universitete të tjera në nivel kombëtar. Megjithëse në Raportin e Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB) nuk është reflektuar qartë kodifikimi i programit sipas VKM nr. 310, datë 11.05.2022, në evidencën nr. 3.27 paraqiten qartësisht procedurat e ndjekura nga UNIKO për këtë proces. Konstatohet se <u>mungon</u> një program i detajuar i praktikës profesionale i hartuar nga pedagogët udhëheqës, i cili do të siguronte më shumë qartësi dhe strukturë në realizimin e kësaj përvoje formuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe nga vizita e realizuar në institucion, rezulton se njësia bazë – Departamenti i Edukimit (DE) – dhe njësia kryesore – Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF) – funksionojnë në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë, si dhe me Statutin e institucionit. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, përbëhet nga 4 njësi bazë: 1. Departamenti i Edukimit; 2. Departamenti I Gjuhës dhe Letërsisë; 3. Departamenti i Gjuhëve të Huaja; 4. Departamenti i Histori dhe Gjeografisë; Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, ku për vitin akademik 2024-2025 kanë kualifikimin si më poshtë:




Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	9
Prof.Asoc	9	7
Dr/PhD	24	7
Msc	7	17
Gjithsej	42	40

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Departamenti i Edukimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	4	1	6	1	5
Prof. Asoc.	-	-	-	3	-	3
Dr./PhD.	5	-	5	-	5	-
Msc.	6	8	6	7	6	8
Totali	12	12	12	16	12	16

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Rezulton se njësia bazë përgjegjëse për zbatimin e Programit të Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” përmbush detyrimet ligjore që lidhen me kualifikimin e stafit akademik. Megjithatë, vlerësohet se departamenti duhet të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të nxitur dhe mbështetur zhvillimin profesional të stafit akademik në drejtim të avancimit shkencor. Nga takimet e zhvilluara me stafin mbështetës dhe me studentët, rezulton se studentët përfitojnë ndihmë nga personeli ndihmës akademik gjatë procesit mësimor dhe në veprimtaritë që lidhen me programin. Sa i takon praktikave mësimore, konstatohet se departamenti angazhon 3 pedagogë tutorë si dhe mësues mentorë në institucionet pritëse

	(kopshte). <i>Megjithatë, siç është theksuar edhe më herët, mungon një program i veçantë lënde për praktikën profesionale, i cili do të sigurojë një strukturim më të mirë të kësaj përvoje formuese.²⁹</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga takimi me stafin që mbulon Programin e Studimit, u konstatua se roli i koordinatorit të programit, i cili është përgjegjës për ndjekjen e ecurisë dhe zhvillimin e tij, përfshirë edhe organizimin e praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit, caktohet nga përgjegjësjë e Departamentit. Gjithashtu, ajo përcakton pedagogët përgjegjës për lëndët përkatëse, të cilët janë pjesë e stafit akademik që angazhohen në mësimdhënie në kuadër të këtij programi gjatë një viti akademik.³⁰ <i>Megjithatë, GVJ rekomandon se Departamenti duhet të përmirësojë funksionimin dhe efektivitetin e këtyre strukturave ndihmëse, pasi nga takimet e zhvilluara me studentët rezultoi se roli i koordinatorit të programit nuk është i njohur nga shumica e tyre, çka tregon për një mungesë komunikimi dhe transparence në këtë aspekt.</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–3 të Standardit II.2, si dhe në gjetjet e evidentuara nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), konstaton se:</i> - Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin; - Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit kanë të punësuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, etj; - Departamenti ka përzgjedhur kordinatoren e programit të studimit i cili ka rol kyç në sigurimin e cilësisë së programit të studimit, megjithatë <i>GVJ rekomandon se Departamenti duhet të përmirësojë funksionimin dhe efektivitetin e këtyre strukturave ndihmëse, pasi nga takimet e zhvilluara me studentët rezultoi se roli i koordinatorit të programit nuk është i njohur nga shumica e tyre, çka tregon për një mungesë komunikimi dhe transparence në këtë aspekt.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

²⁹ “Rregullore e programit të studimit AF 2023-2026” Evidenca nr.2.4

³⁰ “Vendimi i njësisë për përcaktimin e kordinatorëve të programeve të studimit” Evidenca 3.2



				X
--	--	--	--	---

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Konfirmohet se Njësia kryesore – Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF) – dhe Njësia bazë – Departamenti i Edukimit (DE) – disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e Programit të Studimit. Këto informacione janë të pasqyruara në dokumente zyrtare si: Rregullorja e UNIKO-s, Rregullorja e FEF-së, Rregullorja e Departamentit të Edukimit, Rregullorja e Programit të Studimit në Arsimin Fillor, si dhe në kurrikulën përkatëse, planin mësimor të miratuar dhe një sërë udhëzimesh të tjera që rregullojnë zhvillimin e procesit mësimor. ^{31/32/33}
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Programit të Studimit, veçanërisht i planit mësimor dhe programeve të lëndëve (syllabuseve), evidentohet se për secilën lëndë apo modul janë të pasqyruara në mënyrë të qartë dhe të plotë informacionet përkatëse, përfshirë numrin e krediteve, ngarkesën javore dhe atë të përgjithshme në auditor, si dhe detyrimet që studentët duhet të përmbushin në përfundim të lëndës/modulit (provim ose firmë). Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ofron një strukturë të detajuar të lëndëve dhe shtrirjes së tyre përgjatë vitit akademik. Për secilën njësi mësimore jepen të dhëna për kohështrirjen (vjetore ose semestrale), javët mësimore, orët e leksioneve, orët e seminareve, aktivitetet jashtë auditorit, praktikat apo laboratorët. Gjithashtu, përcaktohet tipologjia e lëndës, emrat e pedagogëve të angazhuar dhe numri i krediteve përkatëse sipas Sistemit ECTS. ³⁴
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe	Nga shqyrtimi i dosjes së programit, verifikimet në terren, vizita në institucion si dhe takimet me stafin dhe studentët, konstatohet se studentët kanë mundësi të njihen me përmbajtjen e programit të studimit, si dhe me aspekte të tjera që lidhen me funksionimin e tij, përmes dokumentacionit të publikuar online në faqen zyrtare të institucionit: https://unkorce.edu.al . Informacioni përkatës është i disponueshëm në rubrikën “Informacion i përgjithshëm për

³¹ “Rregullore e programit të studimit AP 2023-2026” Evidenca nr.2.4

³² “Rregullore e brëndëshme e Departamentit të Edukimit” Evidenca nr.2.2

³³ “Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF-së” Evidenca nr. 2.1

³⁴ “Plani mësimor Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” Evidenca nr.2.5

ekuivalentimit të studimeve.	studentët”, si dhe në seksionet e dedikuara për Departamentin e Edukimit (DE) dhe Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë (FEF). ³⁵ Përveç kësaj, mbështetja ndaj studentëve përforcohet edhe përmes rregulloreve dhe udhëzuesve informues, të cilët u vihen në dispozicion studentëve që në ditën e parë të fillimit të vitit akademik, duke i njohur ata me strukturën e programit, kurrikulën dhe detyrimet përkatëse. Gjithashtu, në fillim të çdo lënde, pedagogu përkatës prezanton kërkesat, detyrimet dhe strukturën e kursit në përputhje me planifikimin semestral, duke siguruar transparencë dhe qartësi në procesin mësimor. ³⁶
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Gjatë analizës së kurrikulës dhe programeve të lëndëve, si dhe në vijim të takimeve me stafin akademik, konstatohet se në planin mësimor janë paraqitur në mënyrë të detajuar të gjitha lëndët, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, si dhe me “Rregulloren për organizimin e veprimtarisë mësimore-shkencore në FEF”. Ndër elementët e përfshirë në plan, është shtuar gjithashtu edhe komponenti “Kodi i Etikës”. ^{37/38} Plani mësimor përmban informacione të detajuara për çdo lëndë, duke përfshirë shtrirjen përgjatë vitit akademik, orët e seminarëve, praktikave apo laboratorëve, tipologjinë e lëndës, emrat e pedagogëve të angazhuar në program, si dhe numrin përkatës të krediteve. Gjithashtu, programet lëndore përmbajnë përshkrimin e përmbajtjes së lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet kyçe, temat mësimore, format e kontrollit të njohurive dhe literaturën bazë, duke siguruar kështu një strukturim të qartë dhe të plotë të procesit të mësimdhënies. ³⁹
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga analiza e programeve të studimit për periudhat 2022–2025, 2023–2026 dhe 2024–2027, si dhe nga takimet me stafin përgjegjës për mbulimin e programit, konstatohet se ky program studimi ka pësuar ndryshime si në numrin e krediteve, ashtu edhe në përbërjen e lëndëve. Këto ndryshime janë rezultat i diskutimeve të zhvilluara në fillim të çdo viti akademik ndërmjet Zv. Rektorit për çështjet mësimore, Drejtorisë së Kurrikulave dhe Drejtorit të Departamentit, si dhe të dhënave të mbledhura nga studentët apo udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Vendimeve të Këshillit të Ministrave

³⁵ “ Faqe zyrtare e UNIKO <https://unkorce.edu.al/> (Studentët në rubriken Informacion I përgjithshëm) dhe DE

³⁶ “ Faqe zyrtare e UNIKO <https://unkorce.edu.al/> (Studentët në rubriken Informacion I përgjithshëm) Guida e studentëve.

³⁷ “ Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FEF” Evidenca nr. 2.1

³⁸ “Rregullore e programit të studimit AF” Evidenca nr. 2.4

³⁹ “Programet e programit të studimit AF” Evidenca nr. 2.12

	(VKM). Ndryshimet synojnë pasurimin dhe përmirësimin e programit, si në përmbajtje ashtu edhe në aspektin metodologjik.⁴⁰ Megjithëse në Raportin e Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB) nuk jepen të dhëna të detajuara mbi këto ndryshime, nga analiza e pyetësorëve të studentëve të realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) rezultojnë disa rekomandime të vlefshme, veçanërisht në lidhje me përmirësimin e praktikës profesionale, përdorimin e teknologjisë dhe aspekte të tjera të procesit mësimor.⁴¹			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–5 të Standardit II.3, si dhe në gjetjet e evidentuara nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), vlerëson se Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kriteret dhe dispozitat ligjore në fuqi. Njësia bazë disponon një arkivë të mirëorganizuar që përmban dokumentacionin përkatës të programit, ndërkohë që studentët informohen rregullisht mbi përmbajtjen dhe strukturën e programit, si nëpërmjet platformave online, ashtu edhe gjatë orëve të mësimit në auditor. Programi ka pësuar përmirësime në përbërjen e programeve të lëndëve si dhe në shpërndarjen e krediteve, gjë që dëshmon një qasje dinamike dhe të orientuar drejt cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	Nga shqyrtimi i dosjes së Programit të Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” rezulton se ky program u ofron studentëve një ngarkesë të mjaftueshme teorike dhe praktike, me qëllim zhvillimin e kompetencave shkencore, psiko-pedagogjike dhe profesionale të nevojshme për përgatitjen e tyre për tregun e punës. Programi mbështetet në një kurrikul që paraqet ngjashmëri me

⁴⁰ “Praktika të ndryshimeve në kurrikul” Evidenca nr.2.17; “Plani Mësimor 2022 – 2027” Evidenca nr.2.5

⁴¹ “Të dhëna nga pyetsori me studentë i NJSBC” Evidenca nr.2.23

mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	programet bashkëkohore të së njëjtës fushë të ofruara nga universitete të tjera brenda vendit, duke krijuar gjithashtu mundësinë për vijimësinë e studimeve në nivele më të avancuara të arsimit të lartë.⁴² Konstatohet se programi parashikon jo vetëm orë teorike në auditor, por edhe angazhim praktik përmes punës në laborator dhe veprimtari në terren, të realizuara përmes praktikave aktive dhe pasive në institucione arsimore. Në mënyrë të detajuar, programi përfshin: - 1146 orë leksione; - 901 orë seminare; - 175 orë praktikë në shkollë; - 150 orë për provimin përfundimtar/diplomën e formimit; - Totali 2047 orë në auditor përgjatë tre viteve akademike, si dhe 2453 orë jashtë auditorit.⁴³
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Nga analiza e strukturës dhe përmbajtjes së planit mësimor, ndarjes së veprimtarive formuese sipas kategorive A, B, C, D dhe E, shtrirjes së tyre përgjatë viteve akademike, tipologjisë së lëndëve, pedagogëve të angazhuar dhe krediteve përkatëse, si dhe nga shqyrtimi i formatit të syllabuseve me elementët përbërës të tyre, rezulton se këto elementë janë në përputhje me kërkesat dhe ndihmojnë në realizimin e objektivave formuese të programit, si dhe në arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit.^{44/45} <u>Megjithatë, siç u theksua edhe në takimin përmbyllës me stafin, një pjesë e syllabuseve nuk ndjekin plotësisht formatin e kërkuar nga Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), veçanërisht në lidhje me përfshirjen e temave dhe literaturës për çdo njësi mësimore.</u> Po ashtu, disa lëndë kërkojnë një rishikim të përmbajtjes për të garantuar përputhshmërinë me nivelin e arsimit fillor ku aplikohet programi. Në këtë kuadër, përmenden lëndë të tilla si “Bota sociale e fëmijës”, “Letërsi për fëmijë” dhe “Mesimdhenia dhe te nxenit nepermjet teknologjise”, të cilat paraqesin ngjashmëri tematike me programin e arsimit parashkollor dhe kërkojnë harmonizim të mëtejshëm me objektivat specifike të këtij cikli arsimor.

⁴² “Model diplome dhe suplementi të programit të studimit MAF” Evidenca nr.2.7

⁴³ “Tabele përmbledhëse Anekset” Evidenca nr.4

⁴⁴ “Rregullore e Programit të studimit bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor” (pika 3 objektivat dhe rezultatet e të nxënit) Evidenca nr.2.4

⁴⁵ “Programet e lëndëve model syllabusi” Evidenca nr. 2.12

Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga analiza e dosjes së Programit të Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, si dhe nga takimet me stafin akademik dhe studentët, evidentohet se programi përbëhet nga 180 kredite të shpërndara përgjatë tre viteve akademike, në përputhje me strukturën e lëndëve dhe moduleve që pasqyrojnë profilin e këtij cikli studimi.⁴⁶ Lëndët e përfshira në program prezantojnë ngjashmëri të konsiderueshme me ato të programeve të ofruara nga universitete të tjera në vend, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë⁴⁷ dhe udhëzimet e grupit të punës pranë Ministrisë së Arsimit për unifikimin e kurrikulave. Përmirësimi i strukturës së programit ka ardhur si rezultat edhe i bashkëpunimit me fakultete homologe jashtë vendit, mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara, si ajo me Departamentin e Shkencave të Edukimit “Giovanni Maria Bertin” në Universitetin e Bolonjës. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë përvojat e fituara nga projektet ndërkombëtare si Erasmus+ dhe rekomandimet e dhëna në raportin e ekspertëve të AADF-READ 2024.⁴⁸ Raporti ndërmjet përmbajtjes teorike dhe përvojës praktike konsiderohet i arsyeshëm dhe i përshtatshëm për përgatitjen profesionale të studentëve në këtë fushë studimi.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit të Studimit rezultojnë se ai është ndërtuar në përputhje me kriteret ligjore në fuqi, dhe veprimtaritë formuese janë të ndara sipas disiplinave dhe përqindjes së krediteve, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24.01.2018. Konkretisht, struktura e programit përfshin: - Disiplina të formimit të përgjithshëm (simboli A) – 34 ECTS; - Disiplina të formimit karakterizues (simboli B) – 97 ECTS; - Disiplina ndërdisiplinore/integruese (simboli C) – 22 ECTS; - Lëndë plotësuese (simboli D) – 21 ECTS; - Detyrime përmbyllëse (simboli E) – 6 ECTS;⁴⁹ Struktura e programit mbështet në një raport të balancuar ndërmjet përmbajtjes teorike dhe praktikës, konkretisht 2047 orë në auditor dhe 2453 orë jashtë auditorit (praktikë dhe punë individuale), çka garanton zhvillimin e kompetencave të nevojshme për profilin përkatës. Gjithashtu, vlerësimi i studentëve përmes projekteve dhe metodave alternative përtej provimit tradicional kontribuon jo vetëm në realizimin e objektivave të programit, por edhe në lehtësimin e

⁴⁶ “Plani mësimor I programit AF . Evidenca nr.2.5

⁴⁷ “Vendim I grupit të punës për unifikimin e kurrikulave nga MAS. Evidenca nr.2.18

⁴⁸ “ Marrëveshja me Bolonjën” Evidenca nr. 3.13

⁴⁹ “Tabela përmbledhëse Anekset “ Tabela nr.9

	mundësisë për transferim të studimeve apo punësim në tregun e punës. ^{50/51}
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe takimet me stafin akademik që mbulon programin, rezulton se janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përditësimin e përmbajtjes së lëndëve, të ndikuara kryesisht nga përvojat e fituara në kuadër të projekteve ku janë angazhuar pedagogët, nga kërkesat e tregut të punës, si dhe nga sugjerimet e dhëna nga studentët e diplomuar (Alumni).⁵² <u>Megjithatë, këto përditësime nuk përfshijnë në mënyrë të plotë të gjithë lëndët e programit. Gjithashtu, evidentohet nevoja për më shumë kujdes në përditësimin e literaturës së rekomanduar dhe ndihmëse.</u> Kjo literaturë duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, duke u mbështetur në botime të pesë viteve të fundit, për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën përkatëse. Literatura aktualisht ofrohet edhe në gjuhën angleze dhe është e aksesueshme si në bibliotekën fizike të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, ashtu edhe përmes burimeve të bibliotekave online. Megjithatë, mendohet se është e domosdoshme që për çdo vit akademik të bëhet një përditësim sistematik i literaturës së përdorur në syllabuse, duke përfshirë tekste dhe materiale më të reja, në përputhje me përparimet bashkëkohore në disiplinat përkatëse.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Konfirmohet se Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, përmes 36 lëndëve që përmban, synon të pajisë studentët me njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për të ushtruar profesionin e mësuesit në mënyrë të aftë dhe të përgjegjshme, si dhe për të nxënë gjatë gjithë jetës. Programi mbështetet në lëndë me karakter formues shkencor dhe profesional, të cilat shoqërohen me detyra kursi dhe projekte praktike, duke iu referuar Kompetencave të Arsimit Parashkollor të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare për këtë nivel arsimor, si dhe objektivave të përcaktuara në vetë programin e studimit. ⁵³
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e	Nga analiza e përmbajtjes së Programit të Studimit dhe veprimtarive formuese të hartuar në përputhje me standardet e cilësisë, rezulton se ky program ofron bazën e nevojshme për vijimësinë e studimeve në nivele më të avancuara akademike. Njëkohësisht, ai krijon mundësi reale punësimi për të diplomuarit në institucionet e arsimit fillor, duke përmblusur kështu si funksionin formues, ashtu edhe atë profesional të programit. ⁵⁴

⁵⁰ “Praktika e plotë e procedurave të transferimit të studentëve „ Evidenca nr.2.15

⁵¹ “ Rregullore e organizimit dhe Veprimtarisë mësimore shkencore të FEF” Evidenca nr.2.1

⁵² “Programet lëndore, model syllabusi” Evidenca nr. 2.12

⁵³ “ Rregullore e programit të studimit AP (2023-26)”Objektivat formuese Evidenca nr.2.4

⁵⁴ “ Model diplome dhe suplementi bachelor MAF” Evidenca nr.2.7

tregut e punës.				
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–7 të Standardit II.4, si dhe në gjetjet e evidentuara nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), vlerëson se:</i> <i>Programi i Studimit është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kriteret ligjore në fuqi. Struktura, organizimi dhe përmbajtja e tij janë të harmonizuara me objektivat formues të programit, me nivelin përkatës të kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, si dhe me Kornizën Shqiptare të Kurrikulës së Arsimit Fillor. Programi synon zhvillimin e kompetencave të nevojshme për punësimin e të diplomuarve në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Megjithatë, GVJ rekomandon që të intensifikohen përpjekjet për rishikimin dhe përmirësimin e tërësishëm të lëndëve në të gjithë komponentët e tyre, me theks të veçantë në përditësimin e literaturës së përdorur dhe përshtatjen e tematikave të disa lëndëve në funksion të karakteristikave të arsimit fillor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në Raportin e Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB) të paraqitur nga grupi i punës lidhur me këtë kriter, rezulton se dokumentacioni i disponuar nga institucioni – përfshirë Statutin, rregulloret e studimit të fakultetit, departamentit dhe vetë programit të studimit – si dhe raportet e analizave të realizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), dëshmojnë për një angazhim të vazhdueshëm drejt përmirësimit të Programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”. ⁵⁵ Në këtë kontekst, vërehet se janë ndërmarrë disa ndryshime në përbërjen e lëndëve dhe përmbajtjen e tyre, sidomos në aspektin e shpërndarjes së krediteve. Megjithatë, mungon një evidencë e dokumentuar që të reflektojë konkretisht sugjerimet e marra nga stafi akademik, studentët apo rekomandimet

⁵⁵ “Statuti I UNIKO-së” “Rregullore studimi e UNIKO-së” “Rregullore e DE” Evidencat nr. 1.1;1.2;2.2

	<i>e lëna nga NJSBC.</i> Nga ana tjetër, NJSBC ka dhënë rekomandime të qarta në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse për realizimin e programit, zhvillimin e praktikës profesionale dhe përditësimin e literaturës, por jo domosdoshmërisht për ndryshime strukturore në planin mësimor apo në përmbajtjen e lëndëve.⁵⁶
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga takimet e zhvilluara me stafin akademik, studentët dhe përfaqësues të Sektorit të Karrierës dhe Alumnit, rezulton se studentët janë të përfshirë në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse dhe strukturat e sigurimit të cilësisë, përfshirë Senatin Akademik, Këshillin Studentor dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Departamenti i Edukimit organizon takime dhe diskutime të hapura me studentët dhe përfaqësues të tregut të punës, me qëllim mbledhjen e mendimeve dhe sugjerimeve për ndryshimet e nevojshme që duhen ndërmarrë në përmbajtjen dhe strukturën e programit.⁵⁷
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF) dhe Departamenti i Edukimit (DE), si njësitë përgjegjëse për realizimin e Programit të Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, rezulton se në funksion të përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të këtij programi, kanë zhvilluar bashkëpunim të ngushtë jo vetëm me njësi të brendshme të institucionit, si Drejtoria e Koordinimit të Veprimtarive Institucionale (DKVI), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Sektori i Koordinimit të Veprimtarive të Integruara Akademike (SKVIA), por edhe me institucione homologe brenda vendit, si Universiteti i Tiranës (UT), Universiteti “Aleksandër Moisiu” i Durrësit (UE), organizata dhe shoqata profesionale, si dhe me universitete partnere jashtë vendit, si Universiteti i Selanikut.^{58/59}
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kritereve 1–3 të Standardit II.5, si dhe në gjetjet e evidentuara në dokumentacionin e dorëzuar dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), konstaton se:</i> <i>institucioni nxit dhe promovon përfshirjen aktive të studentëve, partnerëve institucionalë, rrjeteve akademike dhe organizmave të tjerë përkatës në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit, megjithatë <u>GVJ rekomandon</u></i>

⁵⁶ “Të dhëna nga pyetsori me studentët nga NJSBC dhe SKVIA” Evidenca nr.2.23

⁵⁷ “Manuali I cilësisë së UNIKO” (Roli i aktorëve në UNIKO për sigurimin e cilësisë) Evidenca 1.16

⁵⁸ “Plani mësimor bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor 22.27” Evidenca nr.2.5

⁵⁹ Marrëveshje në rang fakulteti “ Evidenca nr.3.14

	të rishikohet përmbajtja e disa lëndëve dhe të afrohet më shumë me objektivat formues të përcaktuara për nivelin e arsimit fillor, në mënyrë që të sigurohet koherencë mes përmbajtjes mësimore dhe nivelit të synuar të edukimit. Departamenti ka prioritet përmirësimin dhe përditësimin e kurrikulave në shërbim të njohurive të nevojshme për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), nga takimet e zhvilluara me stafin akademik të programit dhe me studentët, konstaton se në programet lëndore të Programit të Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” zbatohen forma të ndryshme dhe të larmishme të mësimdhënies, të të nxënit dhe të vlerësimit. Këto përfshijnë: mësim në auditor (leksione, seminare, laboratorë, orë të hapura), studim individual, vlerësim përmes testimeve me gojë dhe me shkrim, detyra kurs/ese, punë në grup, projekte, si dhe zhvillimin e praktikave profesionale. Të gjitha këto forma zbatojnë formatin e përcaktuar në Statutin dhe rregulloret përkatëse të institucionit. ⁶⁰ Gjithashtu, evidentohet se ekziston një sistem funksional monitorimi për garantimin e cilësisë së zbatimit të këtyre formave të mësimdhënies dhe të vlerësimit, i cili realizohet nga njësitë përgjegjëse institucionale. ⁶¹
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet	Nga analiza e pyetësorit të realizuar me studentët nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), rezulton se, në

⁶⁰ “Rregullore dhe statuti i UNIKO” Evidenca nr.1.1 ; 1.2

⁶¹ “Raport I analizës vjetore të punës mësimore shkencore të DE 2023-24” Evidenca nr.2.10

larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	përgjithësi, studentët shprehen të kënaqur me larminë e metodave të mësimdhënies të përdorura nga pedagogët, të cilat vlerësohen si të përshtatshme dhe në përputhje me nevojat e tyre akademike. Njësia bazë ka vendosur në funksion një sistem trajnimi për stafin akademik, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së pedagogëve dhe zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, në përputhje me objektivat formues dhe zhvillimore të programit të studimit. ^{62/63}
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Gjatë takimit me stafin e Departamentit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) ka evidentuar se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF) dhe njësia bazë – Departamenti i Edukimit (DE) – mbështesin në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin profesional të stafit të tyre akademik, me qëllim përmirësimin e kompetencave në fushën e mësimdhënies. Konstatohet se personeli akademik është inkurajuar dhe ka përfutur nga programe të ndryshme mobiliteti në universitete homologe, të mundësuar përmes marrëveshjeve ndër-institucionale të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në projekte të financuara nga programi Erasmus+. Këto përvoja kanë ndihmuar në rritjen e kapaciteteve akademike dhe në pasurimin e praktikave pedagogjike përmes shkëmbimit të eksperiencave me institucione të arsimit të lartë në nivel ndërkombëtar. ^{64/65}
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga takimet me pedagogët dhe studentët, analiza e raportit të pyetësorit të realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe verifikimet në Zyrën e Burimeve Njerëzore, konstatohet se personeli akademik angazhohet në mësimdhënie në përputhje me profilin e tyre profesional, kualifikimet dhe fushën e kërkimit shkencor. ⁶⁶ Vërehet një përmirësim i ndjeshëm në të gjithë komponentët e procesit mësimor. Studentët inkurajohen të marrin pjesë aktive gjatë leksioneve, në realizimin e detyrave të kursit, si dhe në projekte individuale apo në grup. Nga ana tjetër, studentët raportojnë për marrëdhënie të mira komunikimi me pedagogët, si dhe për akses të rregullt në informacionin e nevojshëm përmes postës elektronike institucionale dhe orarit të pritjes të përcaktuar për secilin lektor. ⁶⁷

⁶² "Raport i analizës vjetore të punës mësimore shkencore të DE 2023-24" Evidenca nr.2.10

⁶³ "Qendra e Formimit të vazhdueshëm " Faqja zyrtare e UNIKO-së. <https://unkorce.edu.al/> (rubrika rreth nesh)

⁶⁴ "Lista përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale" Evidenca nr.3.10

⁶⁵ "Certifikate pjesëmarrjeje e stafit akademik në marrëveshje ndërkombëtare" Evidenca nr. 3.15

⁶⁶ "Procedura të rekrutimit të Stafit Akademik." Evidenca 3.5 dhe 3.6

⁶⁷ "Model analize në fund të një moduli" Evidenca nr. 2.28

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nga takimet me stafin akademik dhe studentët, konstatohet se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF) dhe Departamenti i Edukimit (DE), si njësi përgjegjëse për Programin e Studimit, kanë vlerësuar dhe mbështetur procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies të përdorura nga pedagogët. Kjo është realizuar përmes trajnimeve të zhvilluara nga sektorë të ndryshëm të institucionit, si Agjencia Kombëtare për Koordinimin e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (AKKSHI) dhe Zyra Erasmus+. ⁶⁸ Megjithatë, vërehet se aktualisht mungon një program i strukturuar dhe i qëndrueshëm për trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Nga ana tjetër, institucioni ka treguar një angazhim të dukshëm në vlerësimin e rregullt të programit të studimit, përmes mekanizmave të ndryshëm si feedback-u i studentëve (nëpërmjet pyetësorëve, sondazheve), opinioneve të stafit akademik dhe analizave të përgatitura nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Këto të dhëna janë marrë në konsideratë për të nxitur përmirësime në mësimdhënie, nëpërmjet integritetit të metodologjive dhe teknologjive bashkëkohore. Gjithashtu, Departamenti realizon vlerësimin periodik të performancës së pedagogëve, çka përbën një mekanizëm efektiv për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin profesional të stafit. ⁶⁹
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, si dhe nga takimet e zhvilluara me zëvendësdekanin dhe përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, konstatohet se Universiteti i Korçës (UNIKO), në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht nenin 37, pika 1 dhe nenin 38, si dhe nenet 7, 20 dhe 23 të Rregullores së Brendshme të UNIKO-s, ka në funksion një mekanizëm të qartë për bashkëveprimin dhe kontrollin e njësisë përgjegjëse për programin e studimit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies. ^{70/71}

⁶⁸ “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së projekteve dhe Kërkimit Shkencor”. Evidenca nr.1.23.

⁶⁹ “Raport institucional i vlerësimit të brendshëm të NJSBC të UNIKO” Evidenca nr. 2.19.

⁷⁰ “Rregullore e UNIKO-s. Evidenca nr.1.2


⁷¹ “Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional” Evidenca nr.1.5

mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.				
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–6 të Standardit III.1, si dhe në gjetjet e reflektuara në dokumentacionin e dorëzuar dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), konstaton se:</i> <i>institucioni garanton një proces të strukturuar të të nxënit, duke siguruar aftësimin profesional dhe shkencor të studentëve përmes metodave dhe praktikave bashkëkohore që vendosin studentin në qendër të procesit mësimor;</i> <i>Këto metoda mbështesin në mënyrë të qëndrueshme arritjen e rezultateve të planifikuara të të nxënit, në përputhje me objektivat formues të programit;</i> <i>Departamenti i Edukimit përgjegjës për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Zhvillimi i teknologjisë i ka sjellë më afër marrëdhënien pedagog student.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL), si dhe nga diskutimet me pedagogët dhe studentët, evidentohet se kriteret dhe mënyrat e testimit, vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe sjelljeve etike janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Programit të Studimit të UNIKO-s, konkretisht në nenet 63, 64, 66, 71 dhe 73, si edhe në programet përkatëse të lëndëve (syllabuset). ^{72/73} Këto informacione u komunikohen studentëve në fillim të çdo lënde/moduli nga pedagogët përkatës. Studentët gjithashtu marrin informacion të vazhdueshëm mbi format dhe procedurat e vlerësimit përmes platformave zyrtare të komunikimit të institucionit, si faqja

⁷² “ Rregullore e UNIKO” Evidenca nr. 1.2

⁷³ “ Programet e lëndëve syllabuset” Evidenca nr. 2.12



	zyrtare e UNIKO-s, rrjetet sociale, grupet mësimore dhe sistemi elektronik PITAGORA. ⁷⁴
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga verifikimi i dokumentacionit në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), si dhe nga diskutimet me studentët, rezulton se në ditën e parë të zhvillimit të mësimit për çdo lëndë, pedagogët titullarë prezantojnë për studentët metodologjinë e testimit, duke përfshirë vlerësimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin përfundimtar (provimin), në përputhje me përmbajtjen e parashikuar në syllabuset e lëndëve apo moduleve. Ky informacion i detajuar u bëhet i aksesueshëm studentëve edhe përmes Udhëzuesit të Studentit, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të UNIKO-s, në rubrikën “Studentët”. Gjithashtu, gjatë gjithë vitit akademik, studentët mund të konsultohen me këtë informacion edhe përmes platformave digjitale të menaxhimit të të dhënave akademike, si sistemet ESSE3 dhe PITAGORA. ⁷⁵
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Nga shqyrtimi i Rregullores së UNIKO-s dhe të Programit të Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin fillor”, ⁷⁶ si dhe nga bisedat e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, konstatohet se vlerësimi i studentëve mbështetet në një sistem të kombinuar të vlerësimit të vazhduar dhe provimit përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar përfshin testime të ndërmjetme, pjesëmarrjen aktive në seminare, realizimin e projekteve dhe detyrave të kursit, ndërsa provimi final përfaqëson komponentin përmbyllës të vlerësimit për secilën lëndë. Në përputhje me Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore-Shkencore të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (FEF), konkretisht në nenin 91, në UNIKO aplikohet sistemi i vlerësimit me pikë që konvertohet në notë sipas shkallës vlerësuese si më poshtë: (1–39 pikë = nota 4; 40–50 pikë = nota 5; 51–60 pikë = nota 6 ; 61–70 pikë = nota 7; 71–80 pikë = nota 8; 81–90 pikë = nota 9; 91–100 pikë = nota 10). Ky sistem vlerësimi siguron transparencë dhe objektivitet në matjen e performancës akademike të studentëve. ⁷⁷
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe	Departamenti i Edukimit (DE), si njësi bazë përgjegjëse për zbatimin e Programit të Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin fillor”, përdor një sërë formash dhe aktiviteteve për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Këto përfshijnë organizimin e diskutimeve të hapura brenda njësisë bazë, përfshirjen aktive të studentëve në procesin mësimor përmes formave të ndryshme të ndërveprimit, si dhe vlerësimin sistematik të cilësisë së

⁷⁴ “ Faqja zyrtare e UNIKO” <https://unkorce.edu.al/> (Rubrika Studentët.Informacion i përgjithshëm)

⁷⁵ “ Manual I Sistematik Elektronik Pitagora” Evidenca nr.1.6.1

⁷⁶ “ Rregullore e programit të studimit AP (2023-24) . Evidenca nr.2.4

⁷⁷ “ Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Msimre Shkencore në FEF” Evidenca nr.2.1

duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	mësimdhënies përmes pyetësorëve të studentëve dhe analizës së të dhënave të mbledhura nga vërtetimet e realizuara nga strukturat përkatëse të Rektoratit. ^{78/79} Të dhënat e grumbulluara nga këto mekanizma analizohen dhe rivlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies dhe rritjen e performancës profesionale të stafit akademik. ⁸⁰
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga vlerësimi i veprimtarisë së strukturave përgjegjëse për mësimdhënien, si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin pedagogjik dhe studentët, rezultoi se institucioni i arsimit të lartë i kushton rëndësi të konsiderueshme përdorimit të metodave fleksibël, të personalizuara dhe të larmishme në procesin mësimor. Këto metoda synojnë të mbështesin realizimin efektiv të objektivave formuese të programit dhe të sigurojnë një përgatitje të qëndrueshme të studentëve, në përputhje me nevojat dhe kërkesat në ndryshim të tregut të punës. Diskutimet me studentët konfirmuan se pedagogët zbatojnë një gamë të gjerë teknikash mësimdhënieje dhe kanë ndërtuar një mjedis mbështetës e bashkëpunues, që nxit pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin e tyre në procesin akademik. Kjo qasje kontribuon në rritjen e cilësisë së të nxënësve dhe në zhvillimin e kompetencave të nevojshme për sukses profesional dhe personal. ⁸¹
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–5 të Standardit III.2, si dhe në gjetjet e evidentuara në dokumentacionin e dorëzuar dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), konstaton se:</i> <i>institucioni zbaton rregullore dhe procedura të posaçme për testimin dhe vlerësimin e njohurive, aftësive profesionale dhe kompetencave të studentëve, duke garantuar zbatimin e tyre në përputhje me standardet përkatëse;</i> <i>Departamenti dhe personeli akademik përgjegjës për programin e studimit ka prioritet përditësimin dhe përmirësimin e formave të mësimdhënies, në këtë proces një rol të rëndësishëm ka mendimi i studentëve, i cili tërhiqet me anë të anketave, ku pyeten edhe për format dhe metodat e mësimdhënies;</i>
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

⁷⁸ Raport i analizës së punës mësimore shkencore të DE (2023-24). Evidenca nr. 2.10

⁷⁹ “Të dhëna nga pyetësi me studentë NJBSC SKVIA” Evidenca nr. 2.23

⁸⁰ “Të dhëna nga Pyetësi i NJBSC” Evidenca nr. 2.22

⁸¹ “Rregullore e UNIKO” Evidenca nr. 1.2



standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga shqyrtimi i Rregullores së Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës (UNIKO), konkretisht <i>neneve 76, 77, 78 dhe 84</i> , si dhe nga rregulloret e njësive kryesore dhe njësive bazë, si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, konstatohet se procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale të studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik nëpërmjet një skeme të kombinuar vlerësimi. Vlerësimi i vazhduar zë 30% të notës përfundimtare dhe përfshin testime ndërmjetëse, pjesëmarrje në seminare, realizim projektesh dhe detyra kursi, ndërsa provimi final i lëndës përfaqëson 70% të totalit, duke e çuar vlerësimin përfundimtar në një total prej 100 pikësh. Studentët informohen për pikët e fituara gjatë vitit nga pedagogu i lëndës përkatëse, dhe këto të dhëna pasqyrohen në sistemin elektronik PITAGORA. ⁸² Format e vlerësimit, së bashku me përbërës të tjerë të lëndës, janë të përfshira në syllabus-in përkatës dhe prezantohen në mënyrë të qartë për studentët në fillim të çdo lënde nga pedagogu titullar.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga takimet e zhvilluara me stafin akademik, studentët dhe përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, konstatohet se UNIKO ka filluar zbatimin e sistemit të automatizuar të korrigjimit të provimeve, në kuadër të projektit Clean Score , i financuar nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF). Ky sistem aplikohet në vlerësimin e testimeve me shkrim dhe përfshin gjithashtu përdorimin e teksteve ndërkombëtare të përkthyer në gjuhën shqipe. Nga diskutimet me studentët u evidentua se kjo formë vlerësimi perceptohet si tepër efikase dhe e besueshme, pasi garanton objektivitet në korrigjim dhe mundëson marrjen e menjëhershme të feedback-ut për rezultatet.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, përfshirë Rregulloren e UNIKO-s dhe syllabuset e lëndëve, si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, konstatohet se vlerësimi përfundimtar i një lënde përbëhet nga dy komponentë kryesorë: 1. vlerësimi i vazhduar, i cili përfshin elementët e përcaktuar në

⁸² “ Rregullore e Universitetit Fan S. Noli Korçë” Evidenca nr.1.2

	syllabus-in përkatës; 2. vlerësimi përmes provimit final; Sipas dispozitave të Rregullores, gjatë zhvillimit të provimeve është e detyrueshme prania e të paktën dy pedagogëve në auditor: njëri prej tyre është kryetar i komisionit të provimit (titullari i lëndës/modulit), ndërsa tjetri është anëtar i të njëjtit grup mësimor që mbulon lëndën. Përmbajtja e testit të provimit përgatitet nga pedagogu përgjegjës, ndërsa miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili ka për detyrë të verifikojë nivelin e përmbajtjes së tezës, shkallën e vështirësisë, kohëzgjatjen e provimit në raport me natyrën e pyetjeve, si dhe shpërndarjen e pikëve për secilën pjesë të vlerësimit.⁸³
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Konstatohet se procesi i vlerësimit të njohurive të studentëve, si gjatë vitit akademik ashtu edhe në provimin përfundimtar, shoqërohet me komente shpjeguese dhe këshilla që lidhen me procesin e të nxënës, me qëllim orientimin dhe mbështetjen e studentit drejt përmirësimit të performancës në të ardhmen. Ky element u konfirmua gjithashtu edhe gjatë takimeve me studentët. Korrigjimi i provimeve me shkrim kryhet nga komisioni i provimit, dhe rezultatet i komunikohen studentëve brenda një afati prej 8 ditësh nga data e zhvillimit të provimit. Pas publikimit të rezultateve, komisioni organizon ballafaqimin me studentët dhe ofron transparencë të plotë mbi vlerësimin. Institucioni parashikon një periudhë 48-orëshe për paraqitjen e ankesave nga studentët lidhur me procesin e vlerësimit apo korrigjimin e provimit.⁸⁴
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga analiza e Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, si dhe nga diskutimet me pedagogët dhe studentët, konstatohet se gjatë zhvillimit të provimeve, prezantimit të temave dhe realizimit të detyrave zbatohet një sërë rregullash dhe procedurash që lidhen me monitorimin dhe respektimin e parimeve etike, përfshirë kontrollin antiplagjiaturë të punimeve studentore. Rregullorja parashikon qartë se studentët që shkelin dispozitat e Kodit të Etikës, konkretisht <i>nenet 16, 17 dhe 18</i>, konsiderohen mbetës në provim. Shkeljet përfshijnë, ndër të tjera: kopjimin gjatë provimeve, përdorimin e punës së një personi tjetër pa citim të duhur, fabrimin e të dhënave, si dhe mosrespektimin e dinjitetit dhe integritetit profesional të kolegëve studentë, stafit akademik apo personelit mbështetës. Gjithashtu, ndalohet përdorimi i pajisjeve elektronike, përfshirë celularët, gjatë provimeve. Zbatimi i këtyre

⁸³ “ Rregullore e Universitetit Fan S. Noli Korçë” Evidenca nr.1.2

⁸⁴ “ Rregullore e Universitetit Fan S. Noli Korçë” Evidenca nr.1.2

	rregullave garanton integritetin akademik dhe zhvillimin e një mjedisi mësimor të ndershëm dhe të përgjegjshëm. ⁸⁵
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga analiza e dokumentacionit që lidhet me procesin e vlerësimit të studentëve, si dhe nga bisedat me pedagogët dhe studentët, konstatohet se studentët informohen në mënyrë të rregullt dhe në kohë për ecurinë dhe arritjet e tyre akademike. Konkretisht, ata marrin njoftim për notën përfundimtare brenda një afati prej deri në 8 ditë nga data e zhvillimit të provimit, në përputhje me afatet e përcaktuara nga institucioni. Gjithashtu, janë të përcaktuara dhe zbatohen procedura të qarta për paraqitjen e ankesave nga studentët në lidhje me vlerësimin. Sa i përket vlerësimit të vazhduar, rezultatet e testimeve ose detyrave jepen zakonisht në orën e fundit të zhvillimit të seminarit përkatës, duke mundësuar transparencë dhe rikthim të menjëhershëm të feedback-ut për studentët.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Siç është përmendur edhe më sipër, pas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtë të paraqesë ankesë në rast se konsideron se vlerësimi i dhënë nuk pasqyron realisht performancën e tij akademike. Ankesa duhet të bëhet me shkrim brenda së njëjtës ditë të publikimit të rezultatit dhe i drejtohet dekanit të fakultetit përkatës. Më pas, kërkesa i përcillet departamentit përgjegjës, i cili ngre një komision ad-hoc për rivlerësimin e provimit dhe informon pedagogu përgjegjës të lëndës mbi procedurën në vijim. Ky mekanizëm synon të garantojë transparencë, drejtësi dhe mbrojtjen e të drejtave të studentit në procesin e vlerësimit akademik.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nga bisedat me studentët konstatohet se personeli akademik siguron transparencë në procesin e vlerësimit, duke shpjeguar rezultatet e provimeve të ndërmjetme dhe duke mundësuar ballafaqimin individual të studentëve me punimet e tyre. Kjo praktikë u shërben studentëve për të kuptuar kriteret e vlerësimit dhe për të marrë sqarimet e nevojshme lidhur me performancën e tyre akademike. Studentët kanë të drejtë të shqyrtojnë personalisht provimin në prani të pedagogut përkatës, ndërkohë që personeli akademik është i detyruar të regjistrojë notat në sistemin elektronik brenda afateve të përcaktuara institucionalisht. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, procesverbalet e firmosura dhe testet e provimeve ruhen të mbyllura në zarf dhe dorëzohen në sekretarinë mësimore. Pas shpalljes së rezultateve, studenti ka të drejtë të paraqesë ankesë brenda një afati 48-orësh. Ankimimi dhe vendimi përkatës regjistrohen dhe arkivohen nga Dekanati, duke garantuar dokumentimin dhe gjurmueshmërinë e procesit.
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të Standardit III.3, si dhe në gjetjet e evidentuara në</i>

⁸⁵ "Rregullore e programit të studimit" Evidenca nr.2.4

	<i>dokumentacionin e dorëzuar dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), konstaton se:</i> <i>institucioni garanton një proces vlerësimi të drejtë, transparent dhe të mbështetur në meritokraci, duke respektuar të gjitha procedurat e parashikuara për të siguruar integritetin akademik;</i> <i>Format e kontrollit të dijes janë të përcaktuara në syllabusin e çdo lënde është i ndërtuar në mënyrë që të jepet informacion i detajuar për mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm dhe provimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin e miratuar të vitit akademik.</i> <i>Gjithashtu, IAL ka të strukturuar dhe funksional mekanizmin e ankimimit, i cili i mundëson studentit të kërkojë rivlerësim në rast të pakënaqësisë me rezultatet, duke forcuar më tej besueshmërinë dhe përgjegjshmërinë e sistemit të vlerësimit;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Nga analiza e planit mësimor dhe strukturës së lëndëve të ndara sipas veprimtarive formuese – përfshirë lëndët bazë (që ofrojnë përgatitje metodologjike dhe shkencore), lëndët karakterizuese (të orientuara drejt përgatitjes në disiplinën përkatëse), lëndët ndërdisiplinore/integruese dhe ato plotësuese – si dhe nga shqyrtimi i përmbajtjes së tyre, konstatohet se, në tërësi, programi synon të ofrojë njohuri të thelluara teorike dhe të zhvillojë aftësi profesionale që përgatisin studentët për angazhim në arsimin fillor dhe më gjerë. Plani mësimor gjithashtu kontribuon në pajisjen e studentëve me kompetenca të veçanta në përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor, në formimin e elementëve bazë të etikës profesionale dhe të aftësive për komunikim efektiv. Po ashtu, nxit punën në grup dhe përfshirjen në realizimin e projekteve, duke mbështetur zhvillimin e kompetencave të nevojshme për një praktikë mësimore bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse. ⁸⁶
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive	Siç është theksuar më herët, disa lëndë specifike të përfshira në planin mësimor të programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin

⁸⁶ “Plani mesimor i programit “ Evidenca nr.2.6

të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Fillor”, si: “Edukimi teknologjik dhe metodologji”, “Partneriteti me komunitetin”, “Komunikimi pedagogjik”, “Etika profesionale e mësuesit”, “Administrimi i institucioneve shkollore” etj., nuk shërbejnë vetëm për formimin teorik të studentëve, por kontribuojnë gjithashtu në përmbushjen e objektivave të programit përmes zhvillimit të aftësive të veçanta profesionale. Këto lëndë janë projektuar në mënyrë që të pajisin studentët me njohuri praktike dhe kompetenca funksionale të domosdoshme për të ushtruar profesionin e mësuesit në mënyrë efektive dhe etike, duke reflektuar kërkesat aktuale të sistemit arsimor dhe të shoqërisë bashkëkohore. ⁸⁷
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, konfirmohet se Departamenti i Edukimit (DE) realizon analiza të performancës së studentëve në përfundim të çdo lënde, duke i krahasuar rezultatet e arritura me objektivat e përcaktuara në syllabus-in përkatës. Ky proces vlerësimi mbështetet si në administrimin e pyetësorëve të strukturuar, ashtu edhe në intervistat joformale me studentët. Gjatë takimeve, studentët deklaruan se në përfundim të çdo lënde u jepet mundësia të shprehin mendimet e tyre lidhur me përmbajtjen e lëndës, përputhshmërinë e saj me pritshmëritë dhe zhvillimin e kompetencave të fituara. Ata gjithashtu japin sugjerime për përmirësime të mundshme në përmbajtjen dhe metodologjinë e lëndës.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me	Nga analiza e programeve lëndore dhe bisedat me stafin akademik të programit, konstatohet se në përmbajtjen e lëndëve janë të përcaktuara qartë kompetencat që synohet të zhvillohen te studentët, si nëpërmjet punës laboratorike dhe praktikave profesionale, ashtu edhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Sipas vlerësimit të stafit, studentëve u ofrohet mundësia për të zbatuar këto kompetenca në mënyrë aktive gjatë orëve të leksioneve, në diskutimet gjatë seminareve, si dhe përmes përfshirjes në praktikën profesionale – një komponent i veçantë i programit, i cili zhvillohet në mënyrë të strukturuar dhe të integruar. Mësimdhënia në këtë program ndërthur formimin teorik me përvojën praktike dhe realizohet në bashkëpunim me institucione të ndryshme, që korrespondojnë me profilin e përgatitjes së studentëve dhe ofrojnë hapësira për zhvillimin e praktikave në terren. ⁸⁸ <i>Megjithatë, për të përmirësuar më tej përgatitjen praktike dhe profesionale të studentëve, vlerësohet e nevojshme krijimi i ambienteve të posaçme për lëndë si arti figurativ dhe muzikor, arti skenik, si dhe edukimi teknologjik, të cilat kërkojnë infrastrukturë të</i>

⁸⁷ “Plani mesimor 2022-27. Evidenca nr.2.5

⁸⁸ “Programet lëndore të programit” Evidenca nr.2.12

institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	dedikuar për zhvillim cilësor të aftësive praktike.			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga diskutimet me pedagogët me kohë të plotë dhe të pjesshme, rezulton se brenda Departamentit të Edukimit zhvillohen trajnime të brendshme me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe njohjen me forma bashkëkohore të mësimdhënies. Këto trajnime synojnë pajisjen e stafit akademik me njohuri mbi metodat e reja pedagogjike dhe përdorimin e teknologjive moderne që mbështesin përmirësimin e cilësisë në procesin mësimor. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF) dhe Departamenti i Edukimit kanë organizuar në mënyrë të vazhdueshme aktivitete trajnuese që lidhen me zhvillimet më të fundit në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Gjithashtu, janë organizuar periodikisht orë të hapura me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e praktikave të mësimdhënies nga ana e stafit të angazhuar në programin e studimit. ⁸⁹			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–5 të Standardit III.4, si dhe në gjetjet e reflektuara në dokumentacionin e dorëzuar dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), konstaton se:</i> <i>institucioni ka në funksion struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e kulturës së përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe të nxënie në kuadër të programeve të studimit;</i> <i>Syllabuset analizohen dhe shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme në funksion të rezultateve sa më të mira që duhet të arrijnë në përfundim të lëndës së zhvilluar;</i> <i>Këto struktura nxisin ndërgjegjësimin e stafit akademik dhe studentëve mbi rëndësinë e standardeve të mësimdhënies dhe zhvillimit profesional, duke kontribuar në garantimin e një procesi arsimor cilësor dhe të qëndrueshëm;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.


⁸⁹ “ Faqe zyrtare e UNIKO” <https://unikorce.edu.al>



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, si dhe nga takimet me stafin akademik të përfshirë në program, rezultojnë se Departamenti i Edukimit zbaton një procedurë të posaçme për organizimin e provimit përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës, e cila publikohet në mënyrë të qartë dhe transparente për studentët. Në përfundim të programit të studimeve, studentët i nënshtrohen një provimi të përgjithshëm final ose mbrojnë një punim diplome, në varësi të përcaktimeve të programit. Departamenti përcakton pragu e notës mesatare, mbi të cilën studentët fitojnë të drejtën për t’iu nënshtroar këtij procesi përmbyllës. Gjithashtu, respektohen të gjitha procedurat dhe udhëzimet e parashikuara në Manualin e Punimit të Diplomës Bachelor, duke garantuar një proces të rregullt, të standardizuar dhe në përputhje me kërkesat akademike të institucionit.⁹⁰
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbylëse.	Nga takimet me studentët rezultojnë se ata marrin mbështetje të vazhdueshme dhe informacion të qartë në lidhje me procesin e vlerësimit përfundimtar. Konstatohet se ky vlerësim është gjithëpërfshirës dhe mbulon tematika nga fushat kryesore që përfshijn programin e studimit, duke reflektuar objektivat formuese të tij. Në përputhje me <i>nenet 89 dhe 90</i> të Rregullores së UNIKO-s, si dhe me udhëzimet e përcaktuara në Manualin për hartimin e temës së diplomës, udhëheqësi i temës harton një program pune individual për studentin, duke përcaktuar edhe afatet e përafërta për realizimin e secilit fazë të punës. Respektimi i këtyre afateve nga ana e studentit është thelbësor për mundësimin e mbrojtjes së diplomës brenda sezonit të rregullt. Gjithashtu, personeli akademik luan një rol aktiv në orientimin e studentëve për përzgjedhjen e temave të diplomës, si dhe në mbështetjen e tyre gjatë gjithë procesit të zhvillimit dhe finalizimit të punimit.⁹¹
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Nga takimet me stafin akademik, Përgjegjësin e Departamentit dhe Dekanin, rezultojnë se provimi për formimin final ose punimi i diplomës realizohet para një komisioni të posaçëm, të përbërë nga anëtarë të stafit akademik të departamentit, përkatës për fushat që mbulon programin e studimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani. Komisioni i provimit përfundimtar përbëhet nga titullarët e lëndëve të përzgjedhura, të cilët janë përgjegjës për hartimin e tezës së provimit final. Kjo e fundit mbështetet në literaturën dhe njohuritë që studentët kanë përfutur gjatë viteve të studimeve dhe ka për qëllim testimin e aftësive të tyre në përputhje me objektivat formuese të

⁹⁰ “Rregullore e programit të studimit” Evidenca nr.2.4

⁹¹ “ Rregullore e Universitetit Fan S. Noli Korçë” Evidenca nr.1.2



37

	programit.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin fillor", si dhe në "Manualin e Hartimit të Diplomës", dhe nga diskutimet me stafin akademik të programit, konstatohet se pedagogu udhëheqës i diplomës ka përgjegjësinë për orientimin dhe mbështetjen e studentit gjatë procesit të hartimit të punimit të diplomës. Ky proces përfshin përcaktimin e të gjitha procedurave të nevojshme, përfshirë takimet dhe konsultimet e rregullta me studentin për t'i siguruar mbështetje gjatë gjithë fazës së realizimit.⁹²
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga takimet me studentët, konstatohet se Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) ka mundur mbështetje për studentët lidhur me realizimin e matjeve, testeve dhe analizave të nevojshme për punën e diplomës. Studentët kanë akses në mjediset e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, siç janë laboratorit e teknologjisë, biblioteka dhe instalime të tjera që mbështesin përgatitjen e temës së diplomës. Studentët kanë shprehur se ata ndihmohen në mënyrë aktive nga stafi akademik i Departamentit të Edukimit, i cili i asiston në realizimin e detyrimeve akademike, përfshirë hedhjen e të dhënave tabelare, grafike, dhe analizave statistikore, të cilat janë të domosdoshme për përgatitjen dhe finalizimin e temës së diplomës.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe nga takimet me stafin akademik, konstatohet se zbatohen procedura të qarta dhe zyrtare për përfundimin e provës finale. Në kuadër të vlerësimit të provimit për formimin në programin Bachelor në "Mësuesi për Arsimin fillor", studentët vlerësohen me notë, duke u bazuar në përgjigjet e dhëna gjatë provimit me shkrim. Ky proces vlerësimi realizohet nga një komision prej pesë anëtarësh. Mbrojtja e diplomës bëhet para një komisioni të posaçëm të ngritur nga Departamenti i Edukimit. Vlerësimi i mbrojtjes së diplomës bëhet në përputhje me një formular vlerësimi, ku secili aspekt vlerësohet me 25 pikë, duke rezultuar në një total prej 100 pikësh. Ky rezultat më pas konvertohet në notë, sipas rregulloreve të institucionit.⁹³
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me	Nga takimet me studentët, Sekretarinë, dhe Drejtorinë e Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë, rezulton se, pas përfundimit të studimeve,

⁹² "Manual i hartimit të diplomës" Evidenca nr.2.33

⁹³ "Rregullore e Universitetit Fan S. Noli Korçë" Evidenca nr.1.2



diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	studenti plotëson dokumentacionin e kërkuar dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës (në gjuhën shqipe dhe anglisht), të cilat janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS). Diplomën e nënshkruajnë Dekani/Drejtuesi i njësisë kryesore të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, si dhe Rektori i Universitetit të Korçës (UNIKO). ⁹⁴			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga takimet me Sekretarinë Mësimore, diskutimet me Përgjegjësen e Departamentit dhe bisedat me studentët, konstatohet se institucioni mban dhe ruan kopje të dokumentacionit të studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve. Këto të dhëna paraqiten dhe konfirmohen për secilin student, nëse kërkohen, duke respektuar plotësisht të drejtat e privatësisë. Studentët shprehin se, në përfundim të studimeve, ata kanë të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal. Të dhënat e regjistruara dhe të ruajtura janë të disponueshme pranë sekretarive mësimore përkatëse, që përbëjnë regjistrin themeltar. Po ashtu, informacionet e studentëve ruhen dhe menaxhohen në sistemin elektronik të menaxhimit të studentëve, "Pitagora", i cili siguron ruajtjen e të dhënave në formatin elektronik. Të dhënat bazë dërgohen gjithashtu në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. ⁹⁵			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–8 të Standardit III.5, si dhe në gjetjet e reflektuara në dokumentacionin e dorëzuar dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), konstaton se:</i> <i>Institucioni zbaton procedura zyrtare dhe transparente për detyrimet përmblylëse të studentëve në programin e studimit. Gjithashtu, ai siguron pajisjen e studentëve me dokumentacionin përkatës, i cili është në përputhje me standardet dhe kërkesat e përcaktuara;</i> <i>Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të të gjithë studentëve të rregjistruar në të gjithë ciklet e studimit për një kohë të caktuar;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

⁹⁴ "Model diplome bachelor në "Mesuesi për Arsimin Fillor". Evidenca nr.2.7

⁹⁵ "Manual i sistemit elektronik PITAGORA" Evidenca nr.1.6.1

				X
--	--	--	--	---

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																							
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Stafi akademik me kohet të plotë dhe me kohë të pjesshme në dispozicion të programit të studimit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” që mbulon Departamenti i Edukimit janë pjesë e këtij departamenti dhe e tre departamenteve të tjera të fakultetit si dhe me Fakultetin e Shkencave natyrore dhe humane, dhe përmbushin kërkesat ligjore dhe janë të kualifikuar.⁹⁶ Në këtë program studimi, referuar Tabelës përmbledhëse- Tabela 6, të dhënat për stafin e angazhuar për mësimdhënie referuar dokumentacionit të marrë gjatë vizitës në institucion gjatë tre viteve akademike paraqiten si me poshtë: ⁹⁷ <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>7</td><td>-</td><td>7</td><td>-</td><td>7</td><td>-</td></tr><tr><td>Doc</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>8</td><td>2</td><td>8</td><td>3</td><td>8</td><td>1</td></tr><tr><td>Totali</td><td>18</td><td>4</td><td>18</td><td>5</td><td>18</td><td>4</td></tr></table> Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik: - Për 2022-2023, 54.5% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 45.5 % janë Msc; - Për 2023-2024, 56.5% e pedagogëve kanë gradë	Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	2	2	2	2	2	2	Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	1	Dr./PhD.	7	-	7	-	7	-	Doc	1	-	1	-	1	-	Msc.	8	2	8	3	8	1	Totali	18	4	18	5	18	4
Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																		
Prof.Dr.	2	2	2	2	2	2																																																		
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	1																																																		
Dr./PhD.	7	-	7	-	7	-																																																		
Doc	1	-	1	-	1	-																																																		
Msc.	8	2	8	3	8	1																																																		
Totali	18	4	18	5	18	4																																																		

⁹⁶ “ Rregullore e programit të studimit AF (2023-2026).Evidenca 2.4

⁹⁷ “ Tabela përmbledhë se për anakset Tabela 6 ” Evidenca nr.4

	shkencore/tituj akademik, 43.5 % janë Msc; - Për 2024-2025, 59 % e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, dhe 41% MSc; Nga shqyrtimi i syllabuseve që mbulojnë dhe fushave të studimit rezulton se të gjithë titullarët e lëndëve që mbulojnë këtë program studimi, kanë nivelin e duhur të kualifikimit dhe fushat kerkimore të tyre përputhet me programin.⁹⁸ <i>Mendojmë se duhet punuar më shumë për nxitjen e pedagogëve me Msc, për një kualifikim të mëtjshëm pasi raporti i pedagogëve me grada dhe tituj eshte 54-59% me ato me Msc.</i>												
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i të dhënave mbi personelin akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në“Mësuesi për Arsimi Fillor” rezulton se stafi akademik efektiv dhe ai nga departamentet e tjera në përgjithësi është në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, date 10.09.2018“Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore te Personelit Akademik ne Institucionet e Arsimit te Lartë” dhe rregullores së UNIKO -së (neni 28 neni 102).⁹⁹ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të marrë gjatë vizitës në institucion sipas tabelave 12.1-12.3, për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK për tre vite akademike është si më poshtë: <table><tr><th>Viti Akdemik</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>96 %</td><td>4 %</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>86.3 %</td><td>13.7 %</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>100 %</td><td>_*</td></tr></table> *shënim: ka mospërputhje midis të dhënave te stafit akademik për vitin 2024-2025, ku sipas tabelës 6.1 rezultojnë 4 staf akademik me kontratë, ndërkohë në tab 12 po për këtë vit akademik ngarkesa mbulohet 100% nga staf akademik efektiv, mungojnë të dhënat për stafin akademik me kontratë. <i>Ajo që bie në sy është se disa pedagogë kanë një ngarkesë mbi normën e lejuar dhe mbulojnë një numër të madh lëndësh jo në përputhje me udhëzimin e MAS.</i>	Viti Akdemik	PAE	PAK	2022-2023	96 %	4 %	2023-2024	86.3 %	13.7 %	2024-2025	100 %	_*
Viti Akdemik	PAE	PAK											
2022-2023	96 %	4 %											
2023-2024	86.3 %	13.7 %											
2024-2025	100 %	_*											
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e	Nga analiza e planit mësimor aktiv 2024-2025 në tabelat e paraqitura lidhur me pedagogët që japin mësim në programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" konstatohet se stafi akademik që mbulon ngarkesën e këtij programi sipas lëndëve gjatë pesë viteve të fundit të funksionimit të tij është në përgjithësi i												

⁹⁸ "Të dhëna për kualifikimin për stafin akademik në programin Bachelor Mësuesi për Arsimin Fillor" Evidenca nr.3.6

⁹⁹ "Rregullore e UNIKO-së Evidenca Nr. 1.2

studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	pandryshueshëm, (me përjashtim të rasteve kur pedagogu ka dalë në pension). ¹⁰⁰ Në zyrën e burimeve njerëzore për të gjithë stafin si PAE ashtu dhe PAK kishte kontrata dhe paguheshin sigurimet shoqërore. Përgjegjësi i Drejtorisë të Financave plotëson librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e përlogaritjes së kontributeve që derdh çdo punonjës, duke garantuar qëndrueshmërinë e stafit akademik efektiv ¹⁰¹
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Në Rregulloren dhe Statutin e institucionit UNIKO-së si dhe dokumentacionit që disponon Departamenti i Edukimit dhe Burimet njerëzore rezulton se janë të përcaktuara procedurat dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit akademik efektiv dhe atij më kohë të pjesshme. Bazuar në rregulloren e institucionit (neni 28,29,36,37,38,39) dhe Departamentit të Edukimit (neni 15,16,17) Departamenti mund të vendosë kritere specifike në përshtatje me kërkesat që ka për pedagogun që do të rekrutojë, kritere që miratohen më pas nga Rektori ¹⁰² Në takimin me njësinë e Burimeve njerëzore u konstatua se në rekrutimin e stafit të ri ndiqen të gjitha procedurat e përcaktuara në rregulloren e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve njerëzore (neni 7), duke filluar nga përcaktimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike, shpallja në APP, ngritja e komisionit të vlerësimit, shqyrtimi i dosjes dhe intervista, të gjitha transparente publikuar në faqen zyrtare ¹⁰³
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga dokumentacionin e paraqitur nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe RVB-ja, theksohet se për të siguruar një mësimdhënie sa më cilësore, programi i studimit ka në dispozicion laboratore të tilla si laborator i multimedias, <i>por nuk rezulton se ka laboratore apo mjedise mësimore në përputhje me natyrën specifike të programit.</i> Aktualisht, DE ka një 1 (një) punonjës të angazhuar si personel ndihmës akademik (sekretare e departamentit) dhe pjesa tjetër e stafit janë personel akademik sipas kërkesave dhe specifikave të këtij programi. ¹⁰⁴
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në	Të gjitha strukturat përgjegjëse të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimit Fillor" të UNIKO-së, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Departamenti i Edukimit, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Sekretaria Mësimore, bazuar në rregulloren e


¹⁰⁰ "Tabela për mbledhje se për anekset Tabela 6" Evidenca nr.6

¹⁰¹ "Rregullore e Drejtorisë së Financave" Evidenca nr.1.8

¹⁰² "Rregullore e UNIKO".Evidenca Nr. 1.2)

¹⁰³ "Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve njerëzore (neni 7)".Evidenca nr.1.4

¹⁰⁴ "Mjediset e Fakultetit Tabela 16". Evidenca nr.4 Tabela përmbledhëse për Anekset.



programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	programit të studimit disponojnë listën e plotë të personelit akademik që jep mësim në këtë program për çdo vit akademik dhe kanë informacion të plotë për realizimin e programit dhe periudhën kohore të realizimit të detyrave përkatëse. Dosjet personale disponohen për çdo anëtar të stafit akademik efektiv dhe ndihmës akademik me kontratë që lidhen me karrierën apo titujt akademik ruhen nga specialisti i sektorit të burimeve njerëzore dhe protokoll arkivit. Kjo zyrë disponon evidencat përkatëse të dokumentacioneve të cilat ruhen dhe në arkivë.¹⁰⁵
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se UNIKO dhe Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me DAR Korce dhe Bashkitë Pogradec, Devoll, Kolonjë, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve të programit të si dhe me institucione të tjera të arsimit fillor .¹⁰⁶ Njësia kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka një manual të praktikës profesionale ku pasqyrohet qellimi objektivat dhe mënyra e vlerësimit të studentëve.¹⁰⁷ Në rregulloren e studimit të UNIKO (neni 89,90) dhe të Departamentit të Edukimit (neni 22) janë të përcaktuara qartë detyrat e strukturave dhe personelit akademik lidhur me detyrimet mbyllëse të studentëve që ndjekin këtë program studimi¹⁰⁸.
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e bëra gjatë vizitës konfirmojmë se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë i ka të sanksionuara në marrëveshjet e lidhura me institucionet pritëse për praktikën mësimore dhe ka përcaktuar qartë detyrimet e personelit mbikqyrës lidhur me studentët, gjatë kohës së praktikës si dhe me plotësimin e raportit përfundimtar dhe formularit të vlerësimit që i dërgohet.¹⁰⁹

¹⁰⁵ “ Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve njerëzore”.Evidenca nr.1.4

¹⁰⁶“ Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese për praktikave profesionale të programit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”.Evidenca Nr.4 (Tabela përmbledhëse Aneksët)

¹⁰⁷ “Formular i vlerësimit të praktikës profesionale të studentëve”.Evidenca Nr.2.35

¹⁰⁸ “ Rregullore e UNIKO-së”.Evidenca Nr. 1.2

¹⁰⁹ “ Marrëveshje bashkëpunimi në funksion të praktikës profesionale” Evidenca 3.12

të tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	<i>GVJ mendon se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe në veçanti Departamenti i Edukimit që mbulon këtë program studimi ka personel akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë, i cili përmbush standardet ligjore dhe akademike në përputhje me fushën e programit.</i> <i>GVJ sugjeron se duhet punuar më shumë për nxitjen e stafit për kualifikim të mëtijshëm, si dhe të rregullojë ngarkesat e tyre konform udhëzimeve të MAS.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në ambientet e FEF-së, rezulton se për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ka një infrastrukturë të mjaftueshme që përfshin ambiente për leksione dhe seminare në ambientet e fakultetit, dhe që mundësojnë një mësim normal të këtij programi, bazuar edhe në numrin në ulje të studentëve. Janë 7 auditore për leksione me sipërfaqe 660 m²; 14 salla për seminare me sipërfaqe 705 m²; laboratorë informatike 2. Në dispozicion është edhe një sallë promovime me sipërfaqe 30 m². 2 salla biblioteke dhe ambiente ndihmëse.¹¹⁰ Stafi akademik si edhe ai administrativ është i sistemuar në 13 zyra në të cilat janë instaluar pajisjet e nevojshme për një funksionim normal të punës. Për lëndë specifike si biologji fizikë përdoren laboratorët e fakulteteve përkatëse.¹¹¹
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë	Konfirmojmë nga vizita e bërë në institucion se në mbështetje të programit të studimit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ka pajisje të teknologjisë bashkohore, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të tyre në mësimdhënie. Godina e FEF është e pajisur me linjë interneti dhe intraneti (kabëll interneti optik) në të gjitha zyrat e personelit, klasat,

¹¹⁰ “Tabele përmbledhëse për anakset (tabela nr.16). Evidenca nr.4


¹¹¹ “Tabele përmbledhëse për anakset (tabela nr.16). Evidenca nr.4

realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	laboratorët dhe auditorët. Gjithashtu, krahas rrjetit të internetit (kabllo/lan) funksionon edhe sistemi ëireless i internetit, duke iu mundësuar studentëve akses interneti edhe në ambientet e jashtme. ¹¹²			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në UNIKO ka mjedise të mjaftueshmë dhe të paisura me aparatura dhe mjetet e nevojshme didaktike dhe teknologjike të cilat janë në dispozicion të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" në përputhje me kërkesat e lëndëve për një formim teorik dhe praktik të studentëve, por shfrytëzohen edhe laboratorët R26 dhe R22 pranë Rektoratit, për lëndë specifike që ka programi. ¹¹³ . Rezulton se nuk ka ambiente apo atelie për lëndët vizatim muzikë. <i>Mendojmë se për një formim profesional më të mirë të studentëve për arsimin fillor, departamenti duhet të krijojë mjedise specifike për edukimin figurativ dhe atë muzikor.</i> <i>Rekomandojmë që fakulteti që mbulon këtë program studimi të krijojë apo përshtasë mjedise mësimore në përputhje me natyrën specifike të programit si për vizatim, pune dore dhe muzikë.</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Konfirmojmë se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, ka në funksion të programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" dy laboratore të informatikës të paisur me kompjutera, laptop, smart bord, projektore etj, paisur nga projekte të ndryshme, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë të mësimdhënies e mësimnxënies si dhe për aftësimin teorik dhe praktik në përputhje me objektivat e programit.			
Konkluzione	GVJ arrin në konkluzionin se institucioni ka mjaftueshëm mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin teorik dhe praktik sipas objektivave formuese të programit të studimit, por duhet të mendojë edhe për mjedise specifike që kërkon natyra e këtij program studimi. <i>Rekomandojmë që fakulteti që mbulon këtë program studimi të krijojë apo përshtasë mjedise mësimore në përputhje me natyrën specifike të programit si për vizatim, pune dore dhe muzikë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹¹² "Tabelë përmbledhëse për kapacitetet infrastrukturore e FEF" Evidenca nr.3.18

¹¹³ "Tabelë përmbledhëse për kapacitetet infrastrukturore e FEF" Evidenca nr.3.18

45



Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në Rregulloren e UNIKO (<i>neni 71</i>) dhe në programet e lëndëve të cilat miratohen në DE çdo vit akademik bazuar në udhëzimin Nr.41 datë 24.01.2018, janë përcaktuar edhe elementët e formatit të programeve lëndore të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ku mes të tjerash edhe literatura bazë dhe e rekomanduar. Kjo literaturë u ofrohet studentëve qoftë fizikisht por edhe digjitale, literaturë e cila gjindet ne bibliotekën e UNIKO dhe në secilin fakultet, dhe online si dhe nga përfitimi i burimeve elektronike EIFL (Electronic Information for Library), e cila siguron marrjen e njohurive të domosdoshme për një formim profesional të studentëve.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Konstatohet nga vizita në institucion se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, bën përpjekje të vazhdueshme për përditësimin e literaturës me botime të reja nepërmjet përcaktimit të një fondi për bibliotekën, bazuar në kërkesat e Departamentit të Edukimit. Punonjësit e bibliotekës Shkencore të UNIKO dhe bibliotekës së FEF, raportojnë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit për të informuar stafin akademik, ndihmës-akademik dhe studentët, mbi botimet e fundit, nëpërmjet e-mail-eve zyrtare. Studentët njihen me këtë informacion nga frekuentimi i bibliotekave fizikisht ose përdorimi i bibliotekës virtuale që është vënë në dispozicion të tyre. <i>Literatura e paraqitur në syllabuset e lëndëve, në përgjithësi është e përditësuar me botime të viteve të fundit, por në disa syllabuse ka vend për përmirësim.</i> ¹¹⁴
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në bibliotekën pranë Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë rezulton se në dispozicion të studentëve krahas literaturës bazë të çdo moduli, kishte edhe literaturë nga autorë vendas dhe të huaj, materiale të cilat mund ti gjejnë të depozituara edhe në bibliotekën e UNIKO, EIFL (Electronic Information for Library), në formë elektronike në Platformën Microsoft Teams.¹¹⁵ Biblioteka garanton një shërbim të barabartë për të gjithë studentët e programe të ndryshme, dhe në këtë aspekt edhe programit Bachelor

¹¹⁴ Syllabuset e lëndëve të programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”. Evidenca 2.12

¹¹⁵ “Tabele përmbledhëse e fondit të bibliotekave” Evidenca nr.3.16

	në "Mësuesi për Arsimin Fillor" që mbulon ky fakultet. Buxheti institucional parashikon fonde vjetore për pasurimin e bibliotekave të fakulteteve me botime të kërkuara nga personeli akademik i çdo njësie, të cilat vihen në dispozicion të studentëve në veprimtaritë e tyre hulumtuese për realizimin e detyrave të kursit, projektet lëndore apo punimet e diplomës.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita në bibliotekën e FEF, si dhe nga verifikimi i fondit të librave që disponon kjo bibliotekë rezulton se në dispozicion të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" është një fond i mjaftueshëm librash në shqip dhe në gjuhë të huaj, dhe që janë në përputhje me literaturën bazë dhe të rekomanduar të programeve të lëndëve, moduleve dhe veprimtarive mësimore të programuara në to. Biblioteka i jep mundësinë studentëve të shfrytëzojnë edhe fondin periodik, gazeta revista si dhe përdorimin e librarisë elektronike.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga vizita në ambientet e Bibliotekës konstatohet se janë krijuar kushte dhe ka akses të barabartë për studentët për shfrytëzimin e ambienteve dhe fondit të saj, nëpërmjet regjistrimit falas dhe mundësisë së përdorimit të bibliotekës online ku studentët marrin informacion si nga literatura shqipe dhe e huaj. Studentët kanë akses dhe përfitojnë nga burimet elektronike EIFL (Electronic Information for Library), dhe rezulton se si anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Shqiptare, kjo bibliotekë ka siguruar akses në burime të ndryshme elektronike, informacione të cilat mund të shfrytëzohen nga çdo student dhe pa pagesë.¹¹⁶
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizita në ambientet e bibliotekës së FEF rezulton se ka ambiente fizike të mjaftueshme dhe është mirë e paisur me programe kompjuterike (internet) dhe video-projektorë dhe pajisje të tjera në shërbim të studentëve. Numri i konsiderueshëm i ambjentëve të bibliotekës (2 salla me sipërfaqe 100 m², dhe përdorimi i pajisjeve kompjuterike, mundëson shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Sipërfaqja e konsiderueshme në ambjentet e bibliotekave, dhe përdorimi i pajisjeve kompjuterike, mundëson shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.^{117/118}

¹¹⁶ "Rregullore e UNIKO" (neni 112) Evidenca 1.2

¹¹⁷ "Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës" Evidenca nr. 3.16

¹¹⁸ "Tabelë përmbledhëse për anakset" (tabela nr.16) Evidenca nr.4

Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Në faqen zyrtare të UNIKO dhe në ambientet e bibliotekës së FEF - së janë të verifikueshme oraret e bibliotekës e cila qëndron e hapur cdo ditë nga ora 8.00 deri 16.00, dhe për informacionin elektronik ora 8.00 deri 20.00. Në situata të vecanta provimesh kjo bibliotekë shërben me ditë dhe orare të përshtatshme për studentët. Referuar RVB-së, kapaciteti i studentëve përdorues është: 1444 studentë dhe fondi i përgjithshëm arrin 770 tituj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. - Biblioteka ofron një hapësirë studimi prej 100 m2 si dhe pajisje kompjuterike në dispozicion të studentëve me stafi të specializuar dhe i trajnuar.¹¹⁹
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitet përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka studentore e FEF rezulton se ka një bashkëpunim të mirë mes strukturave të institucionit për të garantuar cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës si dhe përditësimin e këtij fondi si dhe nivelin e shfrytëzimit të tij. Buxheti institucional parashikon fonde vjetore për pasurimin e bibliotekave të fakulteteve me botime të kërkuara nga personeli akademik i çdo njësie, të cilat vihen në dispozicion të studentëve në veprimtaritë e tyre hulumtuese për realizimin e detyrave të kursit, projektet lëndore apo punimet e diplomës. Aktualisht, UNIKO ka fituar një fond prej 14.000.000 ALL, thirrja e AKKSHI-t për Infrastrukturë të Kërkimit Shkencor për Dixhitalizimin e Fondit të Bibliotekës Shkencore.
Konkluzione	<i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve literaturë bazë, si dhe literaturë ndihmëse në gjuhën e programit dhe në gjuhë të huaj për të gjitha lëndët e kurrikulës.</i> <i>Me të gjithë përpjekjet e institucionit për të vënë në dispozicion si literaturë bashkohore për studentët por edhe një mjedis pune në bibliotekë e cila ka siguruar një fond të mjaftueshëm librash si fizik dhe në rrugë dixhitale, <u>sugjerojmë përditësimin e literaturës sidomos asaj të rekomanduar në programet lëndore/syllabuset duhet të jetë i pranishëm në të gjitha programet lëndore/syllabuset.</u></i>

¹¹⁹ "Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës" Evidenca nr. 3.16

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga dokumentat e paraqitura si dhe në vizitën në institucion rezulton se, UNIKO ka një sistem menaxhimi për administrimin e informacionit për studentë gjatë tërë periudhës së studimit të tyre në një program studimi. Fakulteti Edukimit dhe Filologjisë si njësi përbërëse e saj, administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët nëpërmjet sistemit të ri digjital "PITAGORA". Rubrika Studentët (Guida) dhe Njoftime instaluar në faqen zyrtare të institucionit; Platforma Microsoft Team; Sekretaria Mësimore të integruara me njëra tjetrën japin një mbështetje të plotë për procedurat e administrimit të dokumentacionit të studentëve nga regjistrimi e deri në diplomimin e tyre^{120/121}
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Rezulton se në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë nëpërmjet një sistemi të brendshëm që përbëhen nga struktura të tilla si: <i>Departamenti i Edukimit</i> i cili disponon informacion që lidhet me veprimtarinë akademike dhe kërkimin shkencor të stafit bazuar në rregulloren e tij; <i>Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore</i>, e cila arkivon një bazë të plotë të dhënash të procedurave të punësimit, të kuadrit ligjor, të dokumentacionit përkatës dhe të marrëveshjeve të nënshkruara; <i>Drejtoria e Financës</i> e cila posedon dhe përditëson informacionin në lidhje me stafin akademik dhe administrativ, në funksion të përcaktimit të kategorisë së punonjësve, raportit për ngarkesën mësimore dhe gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me pagat, honoraret, kontributet dhe format e tjera të shpërblimeve; <i>Sekretaria mësimore</i> që disponon të dhëna fizike dhe dixhitale për studentë,¹²² administrojnë tërë informacionin dhe dokumentacionin lidhur me procesin mësimor dhe aktivitetin e pedagogëve. Sistemi PITAGORA pranë FEF si pjesë e veprimtarisë të sistemit të

¹²⁰ "Manual i përdorimit të PITAGORA" Evidenca Nr.1.6.

¹²¹ "Faqe zyrtare e UNIKO. <https://unkorce.edu.al>

¹²² "Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve njerëzore".Evidenca Nr.1.4.)

	UNIKO-së publikon të dhëna mbi programin e studimit që janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të UNIKO dhe të njëjve përkatëse. Ky sistem ku ofrohet programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” siguron akses të informacioneve dhe dokumentave si për pedagogët ashtu edhe për studentët. Në momentin e regjistrimit në sistem, personeli akademik dhe studentët pajisen me një llogari unike dhe me një fjalëkalim për përdorimin e kësaj llogarie. Manuali për përdorimin e sistemit PITAGORA lehtëson përdorimin e sistemit nga studentët dhe stafi akademik,¹²³
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	UNIKO nëpërmjet shërbimeve dixhitale të mundësuar nga platforma “PITAGORA”, mundësohet akses në informacione të ndryshme komunikimi interaktiv në administrimin e të dhënave nga ana e stafit akademik, marrje të informacionit në kohë reale nga ana e studentëve, shërbime më të mira sekretarie dhe lehtëson komunikimin interaktiv me studentët. Nga takimi me stafin akademik dhe studentë rezulton se komunikimi mes tyre bëhet edhe në rrjetet sociale paketës Office 386 dhe adresave elektronike me domain @unkorce.edu.al.¹²⁴
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në rregulloren e SKVIA (neni 13) NJSBC janë përcaktuar qartë detyrat e saj për monitorimin e procesit mësimor, sigurimin e të dhënave për cilësisë e mësimdhënies dhe realizimi i raporteve vjetore për ecurinë e këtij procesi.¹²⁵ Po kështu sekretaria mësimore pranë FEF-së nëpërmjet platformës PITAGORA siguron evidentimin në kohë reale të të dhënave përkatëse lidhur me veprimtarinë mësimore të pedagogëve dhe vlerësimit të studentëve, duke u krijuar mundësi strukturave dhe autoriteteve drejtuese të evidentojnë mangësitë apo mosrespektimin e afateve të përcaktuara në rregulloren e studimit të programit. Mbi bazën e informacionit të mbledhur herë pas here bëhen përpjekje për vlerësimin e aktivitetit mësimor dhe shkencor të stafit, dhe materiali i vihet në dispozicion drejtuesit të fakultetit dhe më pas edhe Zv. Rektorit për mësimin.¹²⁶
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e	Nga verifikimi në faqen zyrtare të UNIKO-së mund të konfirmojmë se janë të publikuara informacione lidhur me FEF-në, misionin dhe vizionin, veprimtaritë, programet e studimit, dhe në këtë kuadër edhe të informacionit që lidhet me programin e studimit Bachelor në

¹²³ “Manual i përdorimit të PITAGORA” Evidenca Nr.1.6.

¹²⁴ “Raport instalimi I projektit Office 386”. Evidenca 2.32

¹²⁵ “Rregullore e organizimit dhe e funksionimit të SKVIA” (NJSBC).Evidenca 1.5

¹²⁶ “Rregullore e organizimit dhe e funksionimit të SKVIA” (NJSBC).Evidenca 1.5; “Manual sistemi elektronik Pitagora” Evidenca nr.1.6.1.

ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Mësuesi për Arsimin Fillor" plani mësimor me lëndët, skeda e programit etj, por vetëm në gjuhën shqipe. ¹²⁷			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni disponon sistemin "PITAGORA" nëpërmjet të cilit administron informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit;</i> <i>Sistemi ka të integruar disa platforma të cilat mundësojnë një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar RVB-së, rezulton se buxheti financiar hartohet çdo vit nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës në drejtimin e administratorit të UNIKO bazuar në rregulloren financiare, dhe miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.¹²⁸ Në takimin me Drejtorin e njësisë bazë u theksua se hartimi i buxhetit të universitetit fillon nga njësia bazë, pra që nga departamenti, duke marrë parasysh nevojat që ka realizimi i secilit program studimi. Në rregulloren e shpërndarjes financiare të institucionit (neni 6) janë të përcaktuara edhe kriteret e financimit të cdo njësie kryesore dhe e programeve të studimit.¹²⁹ Gjithashtu, raporti i analizës mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare mundëson transparencë financiare dhe i jep mundësi njësisë bazë (Departamentit të Edukimit) të jetë pjesë e proceseve vendimmarëse.¹³⁰
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për	Rezulton nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikuar në vizitën në FEF se plani i financimit të programit të studimit Bachelor në

¹²⁷ "Faqja zyrtare e UNIKO <https://unkorce.edu.al>"

¹²⁸ "Rregullore e Drejtorisë Ekonomike" Evidenca nr. 1.7.

¹²⁹ "Rregullore financiare e shpërndarjes së të ardhurave në UNIKO" Evidenca nr.1.8.1.

¹³⁰ "Rraport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore shkencore 22-23 UNIKO" Evidenca nr.2.8.

programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	“Mësuesi për Arsimi Fillor” i ofruar nga Departamenti i Edukimit nuk është i ndarë pasi hartohet si institucion në total për 4 fakultetet. Nga shqyrtimi i buxhetit të institucionit konstatojmë se plani financiar është ndarë sipas strukturës që i përshtatet zërave të ndryshëm të financimit të tillë si: financimin e burimeve njerëzore (paga, shpërblime), shpenzime operative për mirëmbajtjen e ambienteve dhe mjediseve (rikonstruksion i godinës), shpenzime për pasurimin e literaturës në funksion të programeve të studimit, mbulimi i kostove për personelin PAE dhe PAK, dhe shpenzime për bibliotekën online.^{131/132}
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Referuar RVB-së, rezulton se zbatimi i buxhetit është objekt kontrolli nga tre hallka kryesore nga Auditimi i brendshëm financiar që realizohet nga strukturat e kontrollit të brendshëm të institucionit; Auditimi i jashtëm (i kryer në çdo dy vjet) nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; dhe Auditimi i jashtëm, i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, <u>por nuk rezulton se ka njësi auditimi dhe nuk ka raporte auditimi.</u> Në analizën vjetore të UNIKO-së duhet thënë se diskutohet dhe miratohen raporte që lidhen me planin njëvjeçar dhe afatmesëm të institucionit.¹³³
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Konfirmojmë se Administratori i UNIKO-së sipas Udhëzimit Nr. 5, date 19.02.2018 “Per përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” paraqet pranë Senatit akademik dhe Bordit të Administrimit çdo vit sipas afatit të përcaktuar, raportin për realizimin e buxhetit të vitit sipas zërave përkatës ku përfshihen edhe shpenzimet për mbulimin e pragramëve të studimit. Ky raport i dergohet edhe MAS dhe i bëhet i njohur tërë njësive të institucionit¹³⁴ <i>Në RVB theksohet se cdo vit organizohen takime të hapura në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të</i>

¹³¹ “ Rregullore e Drejtorise Ekonomike” Evidenca nr.1.7.

¹³² “ Rregullore financiare e shperndarjes së të ardhurave në UNIKO” Evidenca nr.1.8.1.

¹³³ “Rraport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore shkencore 22-23 UNIKO” Evidenca nr.2.8.

¹³⁴ “ Statuti i UNIKO “ Evidenca nr.1.1

	<i>asamblesë akademike dhe studentëve për të diskutuar për realizimin e buxhetit, por nuk ka asgjë të dokumentuar.</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me buxhetin dhe burimet e financimit në UNIKO si dhe takimi me drejtues të institucionit konfirmojmë se institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë Departamentit të Edukimit dhe ka kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, bazuar në grandin që vjen nga buxheti i shteti, të ardhurat që realizohen nga shërbimet që kryen si dhe të ardhurat që vijnë nga projektet ¹³⁵			
Konkluzione	GVJ mendon se UNIKO garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e programit të studimit, pasqyruar, kjo në gjëndjen financiare të institucionit referuar raporteve financiare vjetore. <i>Sugjerojmë se institucioni duhet të ngrejë zyrën e auditimit nëse plotësohen kriteret, dhe të pasqyrojë më mirë veprimtarinë që lidhen me auditimin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

¹³⁵ "Rraport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore shkencore 22-23 UNIKO" Evidenca nr.2.8.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion rezulton se UNIKO zbaton politika dhe funksionojnë njësi të cilat kanë informacion për studentët mbi ecurinë e ciklit të plotë akademik të tyre, nisur nga kriteret e pranimit, regjistrimit të studentëve, kohëzgjatja e studimeve, njohja e krediteve dhe transferimi i studimeve dhe deri tek lëshimi i diplomës . Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” operon në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për IAL-të, bazuar tek dispozitat e Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë, të pasqyruara në: Statutin e UNIKO, (Kreu VI, Nenet 51,52,55, 64, 66, 70, 71) dhe Rregulloren e Universitetit, (kreu VI, Nenet 41, 42, 43, 45, 46)^{136/137}
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në UNIKO dhe Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë si përgjegjëse e programit të studimit, mund të konfirmojmë se zbatohen procedura transparente për pranimet dhe trajtimin e studentëve gjatë viteve të studimit në ciklin e parë të studimeve. Bazuar në Statutin e UNIKO, Kreu VI, neni 55 dhe Rregulloren e FEF, pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, bëhet sipas udhëzimeve dhe kuotave të paracaktuara në aktet nënligjore përkatëse të Këshillit të Ministrave dhe MAS, për vitin akademik përkatës. Këto programe mund t'i ndjekin shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë jashtë kufijve shtetërore dhe shtetas të huaj, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara, pavarësisht gjinisë, moshës, origjinës apo etnisë.¹³⁸
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë bazuar në propozimin e njësisë bazë Departamentit të Edukimit harton dhe dergon për miratim në Senatin Akademik cdo vit kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve lidhur me programin e studimeve bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015; Statutin e UNIKO (Kreu VI, Neni 55); Rregulloren e UNIKO (Kreu VI, Neni 69); Rregulloren e FEF (Kreu V, neni 46), por në përputhje me natyrën e programit nuk ka kriteret specifike.¹³⁹ Pas miratimit të këtyre kriterëve nga MAS ato publikohen në faqen zyrtare të UNIKO-së.¹⁴⁰

¹³⁶ “ Statuti I UNIKO “ Evidenca nr. 1.1

¹³⁷ “ Rregullore e UNIKO” Evidenca 1.2.

¹³⁸ “ Statuti I UNIKO “ Evidenca nr. 1.1.

¹³⁹ “ Statuti I UNIKO “ Evidenca nr. 1.1; “ Rregullore e UNIKO” Evidenca 1.2.

¹⁴⁰“ Faqja zyrtare e UNIKO (kriteret e pranimit) <https://unkorce.edu.al/ep-content/uploads/2023/06/Kriteret-e-pranimit-2024-2025-1.pdf>

Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Rezulton se Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë si njësi përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" ka një sistem informimi të studentëve dhe të interesuarve për të gjitha procedurat e pranimit dhe informimit të studentëve lidhur mënyrat e vlerësimit, transferimit apo ekuivalentimit të studimeve të mëparshme, të pasqyruara në rregulloren e studimit (<i>nenet 45 dhe 46 dhe 59 deri 65</i>) dhe rregulloren e programit bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor".¹⁴¹ Nepërmjet Zyrës të informimit të studentëve; Sekretarisë mësimore (në formë shkresore dhe elektronike) si dhe në faqen zyrtare të UNIKO (në rubrikën Studentët), janë të aksesueshme procedurat e pranimit dhe konkurimit. Nepërmjet Platformës Pitagora studentët njihen online për përparimin e tyre në kohë reale.¹⁴²
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Nga verifikimi në faqen zyrtare (ëëë.unkorce.edu.al) dhe evidentimit në dokumentacion e bërë nga vizita në institucion, rezulton se UNIKO vë në dispozicion të kandidatëve që duan të vazhdojnë studimet në këtë institucion, informacion në gjuhën shqipe dhe angleze, për programet e studimit, kriteret e pranimit të përgjithshme dhe të veçanta nëse ka, informacion mbi organizimin dhe në këtë kuadër edhe përmbajtjen e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor".¹⁴³ Ka një bashkëpunim mes njësive kryesore të të institucionit dhe Qendrës së karrierës cdo vit akademik për fushatën promovuese për programet e studimit dhe përgatitjes së Guidës së Universitetit.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Nga informacioni i marrë nga vendimet e Senatit rezulton se UNIKO harton çdo vit akademik kriteret për pranimit në ciklin e parë të studimeve Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" duke filluar me propozimin e njësisë bazë, miratimin nga MAS të kriterëve dhe kuotave për kandidatë me aftësi të veçantë, pakicave dhe shtresave të marginalizuara, duke i bërë publike në faqen zyrtare të institucionit.¹⁴⁴
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në rregulloren e UNIKO <i>neni 46 pika 2.b</i> konfirmohet se në konkurim mund të marrin pjesë të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor, dhe për studentët jashtë vendit pas ekuivalentimit të diplomës.¹⁴⁵
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave	Në takimin me Drejtorinë e Financave të UNIKO-së dhe takimin me studentë u konfirmua se cdo fillim viti akademik institucioni

¹⁴¹ "Rregullore e Programit studimit AF" .Evidenca 2.4.

¹⁴² "Manuali i përdorimit të sistemit Pitagora"Evidenca nr.1.6.1.

¹⁴³ "Faqja zyrtare e UNIKO" <https://unkorce.edu.al>

¹⁴⁴ "Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve 2024. <https://unkorce.edu.al>

¹⁴⁵ " Rregullore e UNIKO" Evidenca 1.2.

për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	publikon të dhëna për kriteret dhe mënyrën e aplikimit nga studentët për përfitim për bursa studimi si dhe për përjashtimin nga tarifa shkollore për ti ardhur në ndihmë studentëve që vinë nga shtresat në nevojë. ^{146/147}			
Konkluzione	<i>Bazuar në evidencat e paraqitura dhe nga vizita në institucion konstatohet se UNIKO harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret e pranimit për programet mësimore që ofron, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve që ka miratuar, duke i publikuar ato edhe në online në faqen zyrtare.</i> <i>GVL konstaton se UNIKO ka hartuar politika të qarta për informimin e kandidatëve për student si dhe zbaton politika mbështetëse për shtresat në nevojë të studentëve, duke ofruar bursa për të gjithë ata që plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga evidencat e paraqitura dhe vizita në institucion u evidentua se UNIKO nepërmjet strukturave të caktuara efektive si Departamenti e Edukimit, Zyrës së informimit të studentëve, Sekretarisë mësimore Koordinatorit të programit, vë në dispozicion të studentëve të programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” një informacion të vazhdueshëm lidhur me kërkesat dhe procedurat për vlerësimin dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është i aksesueshëm edhe në rregulloret e institucionit dhe të njësisë kryesore i publikuar në faqen zyrtare të tij.¹⁴⁸ Informimi i studentëve behet edhe nga pedagogët e lëndëve, gjatë prezantimit të syllabuseve e planit mësimor, dhe nga platforma Pitagora që janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit. ¹⁴⁹
Kriteri 2. Institucioni	Në rregulloren e studimeve të UNIKO (neni 60), Rregulloren e FEF

¹⁴⁶“Njoftimi mbi fitimin e bursave” Evidenca nr.3.22.

¹⁴⁷ <https://ëëë.facebook.com/share/p/15fmxDZuGO/>

¹⁴⁸ <https://unkorce.edu.al>. (Studentet Informacion i përgjithshëm.)

¹⁴⁹ Manual perdorimi te sistemit PITAGORA.Evidenca Nr. 1.6.1

informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	(neni 66), Rregulloren e programit të studimit të AF (Transferimet e studimeve) janë përcaktuar kriteret dhe procedurat lidhur me njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe transferimeve të studimeve. ¹⁵⁰ Në këtë rast ngrihet një komision ad-hoc që vlerëson numrin e krediteve që mund ti njihen studentit, si edhe u konfirmua një rast me takimin me studentë.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se UNIKO dhe FEF përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ka një sistem informimi për studentëve që mundëson ato të njihen që në ditën e pare të mësimit në lëndët që përmban kurrikula si me përmbajtjen ashtu edhe me kriteret e vlerësimit të cilat janë të pasqyruara në syllabuset e lëndëve, dhe në rregulloret e studimit të këtij institucionit, njësisë kryesore, dhe rregulloren e programit të studimit. ¹⁵¹ Në takimin me studentë u konfirmua se ato merrnin informacion mbi vlerësimin e tyre edhe nga sistemi Pitagora.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe gjatë vizitës në institucion GJV konstatoi se UNIKO nepërmjet strukturave të tij si “Zyrës së informimit të studentëve”, Sekretarisë mësimore të departamentit” bazuar në rregulloret e institucionit (Rregullore e UNIKO neni 89;90; Rregullore e Programit AF kreul4) të aksesueshme nga te gjithë, jep informacion të detajuar për procedurat e hartimit dhe të mbrojtjes së diplomës, si provimit me shkrim ashtu edhe të përgatitjes së temës së diplomës. Gjithashtu në “Manualin e hartimit të diplomes” studentët njihen me strukturën e punimit shkencor, dhe kërkesat teknike të punimit të saj. Studentët që plotësojnë kriteret e punimit të diplomës me fillimin e semestrit të pestë njihen me listen e temave të diplomës dhe përcaktojnë pedagogun udhëheqës. ¹⁵²
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e	Në faqen zyrtare të UNIKO, (rubrika Studentët) është e aksesueshme tërë veprimtaria e Qendrës të Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit lidhur me informimin në mënyrë periodike të gjithë maturanët dhe studentët e ardhshëm, në lidhje me programin e studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor” Po kështu institucioni publikon Guidën studentore’ rrjetet sociale dhe javën e informimit ku jepet informacion i plotë lidhur me këtë program. ¹⁵³

¹⁵⁰ “Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, neni 60” Evidenca nr.1.1; Rregullore e Programit të studimit AF (2023-2026).Evidenca 2.4.

¹⁵¹ “Syllabuset e lëndëve” Evidenca 2.12; “ Rregullore e UNIKO,FEF dhe Programit studimiAF” Evidenca.nr1.2 ; 2.1;2.4;

¹⁵² “ Rregullore e UNIKO; Rregullore e programit AF”.Evidenca Nr.1.2 ; 2.4.

¹⁵³ “ Material promovuese broshura për promovimin”.Evidenca nr.3.24

studimit.				
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi:</i> <i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre, transferimit të studimeve si dhe njohjes së kualifikimeve të mëparëshme në rast transferimi studimesh.</i> <i>Institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit, dhe përmbylljes së tyre me punim diplome apo provim diplomimi.</i> <i>Institucioni realizon një numër aktiviteteve dhe ofron informacion duke informuar përpara fillimit të çdo viti akademik të interesuarit dhe studentët e ardhshëm për programet e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe në takimin me studentë u konfirmua se FEF nepërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumnit, DE dhe njësive të tjera ndihmëse, ofron studentëve një informacion të plotë dhe të vazhdueshëm lidhur me strukturën kohëzgjatjen dhe organizimin e programit të studimit etj.¹⁵⁴ Gjithashtu pedagogët gjatë paraqitjes të syllabuseve, japin studentëve një informacion të detajuar mbi përmbajtjen realizimin dhe vlerësimin e tyre në lëndët që ata frekuentojnë. Informimi i studentëve bëhet edhe nepërmjet “Udhërrëfuesit studentor” që hartohet dhe publikohet çdo vit në faqen zyrtare të institucionit në rubrikën “ Studentët”. Gjatë vizitave në ambientet e FEF konstatohet se informimi i studentëve të programit Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, bëhet edhe nepërmjet informacionit që gjenden në mjediset e kësaj njësie.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë bazuar në rregulloret e UNIKO ka përcaktuar një kompleks përgjegjësish për tërë strukturat ndihmëse të saj si Qendra e Karrierës dhe Alumni, Platforma

¹⁵⁴ “ Faqe zyrtare e UNIKO. <https://unkorce.edu.al>. (Studentet Informacion i përgjithshëm.)

dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Pitagora, rrjeteve sociale, për informimin e studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndëve, moduleve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me programin Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor". Në takimin me studentë u deklarua se ato merrnin informacion si nga pedagogët, sekretaria mësimore, si dhe nga informacioni i publikuar në faqen zyrtare të UNIKO-së ¹⁵⁵
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Konfirmojmë se në takimet informuese me studentët e programit të studimit, Departamenti në bashkëpunim me QKA, në fillim të çdo viti akademik, informon studentët në lidhje me fushat dhe mundësitë e punësimit pas përfundimit të programit të studimit, duke publikuar për të gjithë të interesuarit njoftime mbi vendet e lira të punës, në faqen ëeb të UNIKO, si dhe në faqen e saj në Facebook. ¹⁵⁶
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstatoi se, pedagogët e departamentit të Edukimit, në javën e parë të fillimit të studimeve, pedagogët e angazhuar në këtë program studimi në orën e parë të fillimit të lëndës së tyre, sekretaria mësimore, si dhe në mënyrë më të dedikuar Koordinatori për programin e studimit, luajnë një rol kyç në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Faqja ëeb e UNIKO si dhe rrjetet sociale luajnë gjithashtu një rol thelbësor në ofrimin dhe përditësimin e informacionit në lidhje me elementë të rëndësishëm të procesit mësimor.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga vizita në institucion konfirmohet se UNIKO ka krijuar dhe ka në funksionim një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit të detajuar në lidhje me programet e studimit të ofruara, stafin akademik, kurrikulën, rezultatet e të nxënit, kurset dhe rezultatet e provimeve, të cilat paraqiten në llogaritë personale të çdo studenti në platformën dixhitale Pitagora. Këto struktura ndihmojnë studentët të marrin informacion për veprimtarinë mësimore gjatë frekuentimit të programit, rregjistrimet në provime dhe rezultatet e vlerësimit, të dhëna për lëndët, mjetet didaktike dhe tekstet. ¹⁵⁷
Konkluzione	GVJ konstaton se: <i>Në faqen zyrtare të UNIKO gjendet i publikuar informacioni i plotë mbi strukturën e institucionit, funksionet e tyre, departamentet, sekretarinë mësimore, bibliotekën dhe ambientet e tjera ndihmëse për njësinë dhe programin e studimit.</i>

¹⁵⁵ " Faqe zyrtare e UNIKO. <https://unkorce.edu.al>

¹⁵⁶ " Faqe zyrtare e UNIKO. <https://unkorce.edu.al> (QKA)

¹⁵⁷ Faqe zyrtare UNIKO <https://unkorce.edu.al>

	<i>Zyra e Karrierës dhe Alumnit ofrojnë studentëve informacion mbi mundësitë e tregut të punës dhe i përfshijnë ata në aktivitete për orientimin në karriere dhe veprimtari artistike.</i> <i>GVJ mendon se standardi përmbushet plotësisht, pasi institucioni ka një sistem efektiv të informimit të studentëve për tërë aspektet e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mësimore pranë UNIKO është njësi që kujdeset për mbajtjen e të dhënave dhe përpunimin statistikor vjetor për numrin e studentëve e të diplomuarve, në të gjithë programet e studimit të ofruar nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion dhe verifikimit të dokumentacionit në Sekretarinë mësimore dhe “Rregullores së Sektorit të Studimeve dhe TIK” rezulton se FEF disponon statistika vjetore të studentëve që rregjistrohen për herë të parë dhe atyre që diplomohen,¹⁵⁸. Statistika vjetore për studentët e diplomuar mban dhe FEF pasqyruara në raportet vjetore të analizës së veprimtarisë mësimore kërkimore të tij.¹⁵⁹
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin	Nga shqyrtimi i dokumentacionit ranë Sekretarisë mësimore dhe verifikimit të tij gjatë vizitës në institucion në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike, regjistrin e diplomave, si dhe të sistemit PITAGORA rezulton se Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon sistemin, mjetet dhe procedurat e informimit të studentëve të programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” me statistika për të gjitha aspektet që lidhen me vazhdimësinë e studimeve të këtij programi.¹⁶⁰. Në këto statistika jepet edhe numri i të larguarve, të transferuar apo edhe të çrregjistruar. Në analizën vjetore të Fakultetit evidentohen për cdo program numri i të

¹⁵⁸ “Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK” Evidenca nr.1.10; Vizita në sekretarinë mësimore. (Referuar regjistrin të përparimit të studentëve dhe regjistrin e diplomimit)

¹⁵⁹ “Raport vjetore të veprimtarisë mësimore e kërkimore të FEF 2023-24,” . Evidenca.Nr.2.9

¹⁶⁰ “Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK” Evidenca nr.1.10 ;Verifikime ne sekretarine mësimore të dokumentacionit.

zhvillohet programi i studimeve.	rregjistruarve cilësia në hyrje, si dhe numri i të diplomuarve dhe cilësia në dalje.¹⁶¹ Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit. Të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për tre vite akademike janë: Viti akademik 2022-2023—10 studentë; Viti akademik 2023-2024—14 studentë; Viti akademik 2024-2025—10 studentë;
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga verifikimi i detyrave dhe përgjegjësi si dhe aktivitetit të sektorëve të këtij institucioni si Sektori i Studimeve dhe TIK; Sekretarisë mësimore dhe Platformës Pitagora rezulton se këto njësi menaxhojnë të dhënat statistikore lidhur me programin e studimit, dhe i kanë të aksesueshme për të gjithë të interesuarit.¹⁶² UNIKO në përputhje me Ligjin Nr 9887 ka miratuar Rregulloren për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.¹⁶³
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Në Statutin e UNIKO (neni 84) dhe në “Raportin e kontrollit të dokumentacionit mësimor” rezulton se planifikohet kontrolli periodik nga njësia SKVIA e cila menaxhon programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, dhe programet e tjera. Kjo njësi bën vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore, merr feedback nga studentët lidhur me realizimin e programit, bën analizë të gjendjes dhe harton një raport <u>por nuk rezulton se ka një plan pune për përmirësimet e mundshme</u>.¹⁶⁴
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e	Konfirmojme se njësia kryesore FEF dhe njësia dhe bazë DE që mbulon programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ka një dokumentacion lidhur me profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, që verifikohet në dokumentacionin e Sekretarisë mësimore dhe raportet e analizës vjetore të punës mësimore shkencore të njësisë.¹⁶⁵ Të dhënat për cilësinë në hyrje të studentëve jepen si më poshtë:

¹⁶¹ “Raport vjetore të veprimtarisë mësimore e kërkimore të FEF 2023-24”, Evidenca.Nr.2.9

¹⁶² “Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK” Evidenca 1.10

¹⁶³ “Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale” Evidenca nr.1.9.

¹⁶⁴ “Raport i kontrollit të ushtruar për dokumentacionin mësimor Evidenca Nr.2.31

¹⁶⁵ “Raport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore De, 2023-2024. Evidenca nr.2.10

duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Viti akademik		Mesatarja në hyrje	
	2022-2023		7,3	
	2023-2024		7,3	
	2024-2025		7,1	
Konkluzione	GVJ konstatoi:			
	UNIKO mban dhe disponon statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar, diplomuar dhe punësuar sipas programeve dhe cikleve të studimit.			
	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke siguruar respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.			
	Departamenti i Edukimit përgjegjës për këtë program studimi analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, punësimin e tyre, duke nxjerrë rekomandimet në funksion të rritjes së cilësisë së programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në Statutin e UNIKO (<i>Kreu VIII, Neni 79, Pika 2</i>) dhe rregullores të fakultetit (<i>Kreu VII neni 99 dhe 100 pika 1</i>) janë përfshirë studentët nepërmjet përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si në: - Senatin Akademik; - Njësinë për Sigurimin e Cilësisë; - GVB-të; - Këshilli studentor; - shoqata dhe forume studentorë;^{166/167} Nga takimi me studentë rezulton se ato ishin organizuar në Këshilla

¹⁶⁶ "Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FEF". Evidenca_Nr.2.1)

¹⁶⁷ "Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.Evidenca Nr.1.1)

	Studentore në nivel njësie kryesore dhe institucioni, dhe veprimtaria e tyre rregullohej sipas përcaktimeve në Rregulloren e Këshillit Studentor ¹⁶⁸
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se aktualisht UNIKO përdor sistemin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve realizohet nga zyra e NJSBC. Sipas RVB-së, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik të UNIKO në masën 10% të numrit të anëtarëve të Senatit; në Këshillin e Etikës të UNIKO; në NJSBC në nivel institucioni dhe në nivel fakulteti; në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) dhe Komisionin e Zgjedhjeve në Fakultet (KZF).¹⁶⁹ Në takimin me studentët u theksua se nepërmjet pyetësorit që realizohet për të dhënë mendime mbi mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, si dhe me përfaqësuesit e tyre në Këshillit studentor, ato shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet që lidhen me rregulloret për veprimtarinë mësimore, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive kulturore, artistike dhe sportive.¹⁷⁰
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Bazuar në dokumentacionin e publikuar në faqen zyrtare të UNIKO dhe shqyrtimit të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e DKVI-së” (Kreu IV, neni 13; Kreu V pika 2) dhe “Rregullores së organizimit të zgjedhjeve të Këshillit Studentor” dhe sektorët përgjegjës mbi ecurinë e procesit mësimor rezulton se, gjatë tërë vitit akademik ushtrohen kontrole në programet e studimit që mbulojnë ato, me instrumenta që sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe pasqyrohen në raportin vjetor të sektorit apo të njësisë.¹⁷¹ Studentët nepërmjet Këshillit studentor të fakultetit japin mendime dhe sugjerime për programin e studimit në takime që organizohen nga ky Këshill me Dekanin e FEF. Sipas drejtuesve të njësisë ndryshimet e bëra në programin e studimit janë edhe rezultat i sugjerimeve të dhëna nga studentët.¹⁷²
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka sanksionuar në “Rregullore e Organizimit dhe veprimtarisë Mësimore kërkimore Shkencore, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, “(neni 69; 83-93) barazine dhe ndershmërinë në

¹⁶⁸ “Rregullorja e këshillit studentor” Evidenca nr.1.17

¹⁶⁹ “Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese” Evidenca nr.1.18.

¹⁷⁰ “Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FEF” Evidenca nr. 2.1

¹⁷¹ “Rregullore e organizimit dhe funksionimit të DKVI-së” Evidenca Nr. 1.5; “Rregullore e Këshillit studentor” Evidenca nr. 1.17.

¹⁷² “Të dhëna nga pyetësorët me studentët NJSBC/ SKVIA. Evidenca nr.2.23

procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	vlerësim, si dhe të drejtën e ankimimit, dhe të rishikimit të vlerësimit.¹⁷³ Nga takimi me studentë u konfirmua se ato kanë mundësinë e ankimimit dhe i njohin procedurat që ndiqen lidhur me këtë problem, dhe kishte raste kur rezultati i provimit të tyre ishte rishikuar nga komisioni I ngritur nga dekanati.			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se UNIKO dhe FEF ka garantuar përfshirjen studentëve në të gjitha organet vendimmarrëse, dhe ka marrë në konsideratë mendimet e tyre për përmisimin e programeve të studimit që ajo ofron.</i> <i>Në Departamentin e Edukimit në protokollin e saj kishte edhe sugjerime të dhëna nga studentët dhe reflektime në ndryshimet e bëra në strukturë apo përmbajtjen e programit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Rezulton nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikuar në vizitën e realizuar në institucion se UNIKO ka vënë në dispozicion të studentëve të rregjistruar në programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" njësi shërbimi dhe informimi të studentëve si: Sistemi Pitagora; Sektori Mësimor dhe TIK-u; Programi i Transparencës i instaluar në faqen zyrtare, (i cili pasqyron një gamë të gjerë informacioni dhe kornizën ligjore të veprimtarisë së stafit akademik, administrativ dhe të studentëve); Paketën Office 365 (për komunikim nepërmjet adresave elektronike staf student); broshura promociionale (Guida e studentëve) etj. ^{174 175}
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin,	Rezulton se UNIKO ka një sistem informimi dhe këshillimi të studentëve për tërë veprimtarinë dhe punën mësimor e të studentëve, duke e sanksionuar me rregullore të njëjve përkatëse mbështetëse të studentëve si Sektori Mësimor dhe TIK; Faqja zyrtare e institucionit;

¹⁷³ "Regulore e organizimit dhe veprimtarise mësimore shkencore të FEF" Evidenca Nr.2.1

¹⁷⁴ " Faqja zyrtare e UNIKO . <https://unk.pitagora.rash.al/>

¹⁷⁵ "Raport Instalimi i projektit OFFICE 365.Evidenca nr.2.32.

ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Kordinatori i programit (ndonëse nuk ndihej shumë efektiviteti tij tek studentët); Rrjetet sociale (FB dhe Instagram) ¹⁷⁶ . Për ndjekjen dhe marrjen informacion për përparimin e studentëve rezulton se funksionon platforma Pitagora, ku studentët regjistrohen nga sektori i IT.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga takimi me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor ku bën pjesë edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni, rezulton se kjo njësi bashkëpunon me Sektorin e Studimeve, Sektorin e Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional me Sektorin e Informacionit dhe Promocionit dhe punon për hartimin dhe nxjerrjen e broshurave dhe fletëpalosjeve që kanë të bëjnë me informimin dhe këshillimin e studentëve mbi procesin mësimor, probleme që lidhen me praktikën mësimore, dhe në mënyrë të veçantë orientimin e tyre për tregun e punës. ¹⁷⁷
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimi me studentë rezulton se Qendra e Karrierës dhe Alumni, menaxhon Rrjetin Alumni, i cili ka në fokus mbarëvajtjen profesionale të studentëve të diplomuar në UNIKO. Ajo krijon kontakte me punëdhënësit potencialë për të promovuar studentët, në kërkim të mundësive të reja të punësimit. Në bashkëpunim me Departamentin e edukimit SKVIA organizon trajnime dhe aktivitete të ndryshme me studentët, ku diskutohet dhe orientohen studentët, mbi zhvillimin e karrierës, hartimin e CV-ve dhe përpilimin e dosjes personale, prezantimin gjatë intervistave të punës etj. Qendra gjithashtu njofton në kohë reale studentët e diplomuar (dhe ata aktualë) për çdo njoftim që vjen nga Zyra e punës. ¹⁷⁸
Konkluzione	<i>GVJ mendon institucioni nepërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni realizon informimin dhe këshillimin e studentëve për veprimtarinë e tyre mësimore dhe për karrierë në mënyrë periodike me aktivitetet që organizon dhe publikimeve në faqen zyrtare të UNIKO.</i>

¹⁷⁶ Faqja zyrtare UNIKO (<http://ëëë.unkorçe.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit>, <http://ëëë.unkorçe.edu.al/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf>, <https://ëëë.unkorçe.edu.al/tarifet-e-sherbimeve>, <https://ëëë.unkorçe.edu.al/sites/default/files/Studentet%20qe%20perjashtohen%20nga%20tarifat.pdf>, <https://ëëë.facebook.com/unkorçe/posts/4017993801558643>, <https://ëëë.facebook.com/unkorçe/posts/4025316040826419>.

¹⁷⁷ " Faqe zyrtare e UNIKO. <http://ëëë.unkorçe.edu.al>

¹⁷⁸ "Jeta studentore dhe veprimtaria e QKA-së" Evidenca nr.3.25

	Njësia bazë që mbulon këtë program studimi është gjithashtu përgjegjëse për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se UNIKO në kuadër të projektit TEAVET ka hapur Qendrën e Formimit të vazhduar me 39 module trainimi, ka hartuar një manual për përgatitjen dhe korrigjimin e provimeve në Clean Score, dhe Microsoft Teams ¹⁷⁹ ¹⁸⁰ si dhe përdorën platforma të ndryshme për të ofruar mësimin dhe vlerësimin e dijeve online si Google Meet / Classroom, Zoom, <u>por nuk rezulton se ka një udhëzues për përdorimin e metodave inovative apo evidencë të realizimit të ndonjë trainimi.</u> Në RVB jepet si manual përdorimi platforma Pitagora por kjo platformë nuk ka lidhje me metodat e mësimdhënies.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademi.	Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga njësia kryesore si dhe vizita e bërë në institucion rezulton se Institucioni dhe strukturat përgjegjëse për këtë program studimi, kanë në funksionim të vazhdueshëm mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor të programit. Në rregulloren e funksionimit të DKVI -së janë të përcaktuara qartë detyrat e NJSBC për një vazhdimësi të monitorimit të procesit të mësimdhënies. Vlerësimi i stafit akademik për cilësinë e mësimdhënies kryhet nëpërmjet pyetësorit të

¹⁷⁹ "Model testimi Clean Score". Evidenca_Nr.2.21

¹⁸⁰ "Manual I mësimi Online" Evidenca nr.3.18

	përgjithshëm i cili zhvillohet nga NJSBC në bashkëpunim me këshillin studentor¹⁸¹. Departamenti dhe NJSBC përdor instrumentë vlerësues si pyetsorë me studente, vlerësohet në kuadër të arritjeve në fushën e akademike dhe kërkimore të gjithsecilit nëpërmjet analizave në përfundim të një moduli, si dhe gjatë analizave vjetore të departamentit sipas modelit të miratuar në manualin e cilësisë.¹⁸².
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe Departamenti i Edukimit bazuar në rregulloret e studimit kanë garantuar përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të procesit mësimor dhe vlerësimit të dijeve. Përdorimi i instrumentave të tillë si pyetsorët me studentët nga SKCS-ja në bashkëpunim me NJSBC-në për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi në fund të çdo semestri, pyetësorët me studentët nga pedagogët e çdo lënde, në përfundim të çdo semestri me qëllim vlerësimin e performancës së pedagogut nga ana e studentëve tergojnë për një përfshirje të studentëve në këtë proces¹⁸³. Bazuar në këto të dhëna hartohen edhe raportet e vlerësimit të brendshëm që janë raporte periodike vjetore dhe japin informacion për zhvillimet gjatë një viti akademik për fushat prioritare¹⁸⁴
Kriteri 4. Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	UNIKO dhe FEF si njësi përgjegjëse për programin e studimit merr të dhëna lidhur me sigurimin e cilësisë nga Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni dhe si u tha edhe më sipër vazhdimisht përdorin mjete dhe teknika të ndryshme për të vlerësuar përparimin e studentëve dhe të procesit mësimor. FEF në analizën vjetore të punës (viti akademik 2023-2024) bën një analizë e gjetjeve nga rezultatet e testimeve të bëra me studentët nga njësitë e sigurimit të cilësisë¹⁸⁵ <i>GVJ sugjeron që FEF apo edhe UNIKO rezultatet dhe analizat e bëra së bashku edhe me plane të punës për përmisimin e mangësive ti bëjnë publike. Ky hap do të sigurojë më shumë transparencë dhe do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe rezultateve të studentëve.</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të	Nga dokumentacioni i shqyrtuar si dhe nga vizita në institucion në takimin me stafin rezulton se institucioni përdor një sërë formash përfshirje për stafin në kualifikime që organizohen, por nuk ka evidenca të tjera që flasin për promovim të praktikave të mira apo

¹⁸¹ "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI". Evidenca_Nr.1.5)

¹⁸² "Manuali i cilësisë UNIKO fq. 32-35".Evidenca_Nr.1.16.

¹⁸³ "Model analize në përfundim të një moduli" Evidenca nr.2.28. " Faqe zyrtare UNIKO-së." Pyetsor studentor.

¹⁸⁴ "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare 2022-2023, UNIKO" Evidenca Nr. 2.8

¹⁸⁵ "Të dhëna nga pyetësorët me studentët NJSBC/ SKVIA" Evidenca nr. 2.23.

praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	formave të nxitjes së personelit akademik për përmisimin e mëtejshëm të mësimdhënies, ndaj <u>GVJ rekomandon</u> se ky promovim duhet të ketë një spektër më të gjërë.			
Konkluzione	<i>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, vecanërisht NJSBC dhe Departamenti i Edukimit, vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe innovative të personelit akademik, raportojnë në instancat përkatëse sipas rregullores së UNIKO;</i> <i>Studentët përfshihen në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit të cilësisë, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, pjesmarrjes në organet e institucionit, si edhe këshillit studentor.</i> <i><u>GVJ rekomandon</u> se duhet punuar në një spektër më të gjërë në promovimin e praktikave të mira, nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, si dhe për hartimin e udhëzuesve për metodat inovative në mësimdhënie;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur konfirmojmë se UNIKO ka një strukturë të plotë për sigurimin e cilësisë në shkallë fakulteti dhe institucioni. Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: Senati akademik; Sektori i Kurrikulave Vlerësimit Institucional dhe Alumni (SKVIA), si pjesë përbërëse e strukturës organizative brenda DKVI-së e cila bashkëpunon me njësitë bazë të UNIKO-së dhe NJBSC-të. Këto struktura punojnë mbi bazën e manualit të cilësisë që funksionon në shkallë institucioni. ¹⁸⁶ Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë Departamentet, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program të cilët së bashku organizojnë takime periodike lidhur me përmisimin e programeve të studimit bazuar në gjetjet e pyetësorëve që bëhen në fund të lëndës apo moduleve. ¹⁸⁷

¹⁸⁶ "Manuali i cilësisë në UNIKO" Evidenca nr. 1.16

¹⁸⁷ "Model pyetësori fund kursi/moduli". Evidenca Nr.2.24

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në Manualin e Cilësisë të UNIKO janë të përcaktuara qartë mënyra e funksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, të detajuara në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sistemi dhe tek “Synimet e Planit të i Zhvillimit Strategjik 2022-2027. DKVI dhe SKVIA koordinojnë punën e NJSBC në fakultete, dhe raportojnë drejtpërdrejt autoritetet dhe organeve drejtuese të universitetit, për masat që duhet të ndërmerren. <i>Në këto njësi janë përfshirë edhe studentë, por nuk ka ekspertë të jashtëm, ndaj rekomandojmë përfshirjen e ekspertëve në NJSBC e fakulteteve dhe në rang institucioni.¹⁸⁸</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UNIKO përdor si vlerësimin e brendshëm ashtu edhe të jashtëm si dhe ka përcaktuar në Manualin e cilësisë edhe instrumentet përkatës për realizimin e vetvlerësimit si të institucionit ashtu edhe të programeve të studimit. Konfirmohet se UNIKO i është nënshtruar 2 herë edhe vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional dhe me vendimin e fundit të BA Nr 2. Date 27/01/2023 ka marrë vlerësim pozitiv 4 vite 2023-2027, dhe është në proces akreditimi të programeve të studimit që ofron.¹⁸⁹
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Nga takimet e organizuara në institucion për grumbullimin e të dhënave për analizat vjetore të veprimtarisë në shkallë njësie bazë, njësisë kryesore dhe si institucion në tërësi bazohet në instrumenta të qartë e të matshëm kryesorë të cilësisë që lidhen me: procesin mësimor, stafin akademik, studentët, organizimin dhe menaxhimin e brendshëm, veprimtarinë mbështetëse, etj, në përputhje edhe me standardet e cilësisë të përcaktuara në dokumentet strategjike të UNIKO.¹⁹⁰
Konkluzione	<i>Institucioni harton politika dhe procedura në funksion të sigurimit të cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregullatore.</i> <i>NJSBC përgatit raporte me tregues sasior dhe cilësor, dhe ua dërgon strukturave përkatëse, të cilat marrin vendime në funksion të</i>

¹⁸⁸ “Raport institucional I vlerësimit të brendshëm të NJSBC në UNIKO” Evidenca nr: 2.19

¹⁸⁹ “Manuali i cilësisë në UNIKO” Evidenca nr. 1.16

¹⁹⁰ “Raport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore FEF, 2023-2024” Evidenca nr: 2.9

	<i>përmirësimit të cilësisë.</i> <i>Institucioni ka ndërtuar një strukturë të plotë dhe ka hartuar rregullore studimit për të ndjekur sigurimin e cilësisë, por nuk ka ekspertë të jashtëm si pjesë e kësaj structure, ndaj GVJ rekomandon përfshirjen e këtyre eksperteve të jashtëm në të gjitha njësitë që merren me sigurimin e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe i verifikuar gjatë vizitës në institucion mund të konkludojmë se institucioni dhe FEF përdor mekanizma të ndryshëm formalë për të realizuar mbikëqyrjen e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” në shërbim të akreditimit, në përputhje me Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore, dhe planit strategjik të institucionit për sigurimin e cilësisë.¹⁹¹ Njësia kryesore organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit nga komision ad-hoc i ngritur në rang njësie duke evidentuar probleme dhe sygjieruar zgjidhje. Rezultat i këtij procesi në vitin akademik 2023-2024 ka një përmisim të kurrikulës duke iu përshtatur udhëzimeve të MAS-së..¹⁹²
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme,	Nga verifikimi i dokumentacionit që lidhet me vlerësimin e tërë veprimtarisë mësimore shkencore të institucionit dhe njësive kryesore dhe nga takimi me drejtues të njësive kryesore dhe njësive

¹⁹¹ “Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FEF”.Evidenca nr: 2.1.

¹⁹² “Praktika e ndryshimeve në kurrikul” Evidenca nr: 2.17.

rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	bazë dhe stafin akademik, rezultojnë se raportet vjetore të punës mësimore dhe shkencore të FEF dhe DE, përfshijnë tërë aspektet e veprimtarisë mësimore shkencore apo kërkimore si dhe formimin profesional të studentëve. Raporti evidenton arritjet por edhe problematikat, bën një analizë tëv realizimit të objektivave dhe pritshmërive, duke dale me përfundime dhe sugjerime për të ardhmen.¹⁹³ <i>Por sugjerojmë se në këto raporte duhet të ketë më shumë forma të promovimit dhe motivimit të praktikave të mira, si dhe përcaktimi me plan konkret pune me afate të caktuara për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.</i>
Kriteri3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Nga vizita në institucion konfirmojmë që UNIKO në kuadër të vlerësimit të realizimit e ecurisë së programit të studimit, aplikon metodologji vlerësimi të drejtpërdrejta, bazuar në Statutin e UNIKO, Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO, 2022-2027, Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e UNIKO-s. Vlerësimi i performancës së veprimtarisë akademike lidhur me programin e studimit, bazohet në instrumentat të tillë si: analiza krahasuese midis standardeve të paracaktuara në formën e objektivave për sigurimin e cilësisë, dhe shkallës së përmbushjes së tyre, orë të hapura leksionesh nga pedagogë me tituj shkencorë (profesorë dhe titullarë lëndësh, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie), vlerësim i rezultateve të provimeve, etj.^{194 195 196}
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion konfirmojmë që UNIKO në kuadër të vlerësimit të realizimit e ecurisë së programit të studimit aplikon metodologji vlerësimi të tërthorta si pjesëmarrja në tryeza të rumbullakëta diskutimesh dhe në trajnime që janë pjesë e kornizës zbatuese të projekteve me partner të huaj, intervistat në panairin e karrierës, anketimet e ndryshme me të diplomuarit në Arsimin Fillor nepërmjet Alumnit , pjesëmarrje e studentëve në takime pune që organizon DA,

¹⁹³ "Raport i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore De, 2023-2024" Evidenca nr: 2.10.

¹⁹⁴ "Manuali për vlerësimin e performancës së stafit akademik" Evidenca nr: 1.24.

¹⁹⁵ "Të dhëna nga pyetësorët me studentët NJSBC/ SKVIA" Evidenca nr: 2.23.

¹⁹⁶ "Shembull i orëve të hapura, FEF" Evidenca nr: 2.26.

atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	me qëllimin për të evidentuar kërkesat apo sugjerimet e tyre, shkëmbim informacioni me institucionet bashkëpunuese etj ^{197 198}			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>FEF realizon monitorimin e programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" në shërbim të sigurimit të cilësisë, në përputhje me Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore dhe planit strategjik të institucionit për sigurimin e cilësisë.</i> <i>Gjithashtu vlerësimi i performancës së veprimtarisë akademike lidhur me programin e studimit nga FEF realizohet me metoda dhe teknika të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të cilat pasqyrohen në raportet vjetore që kjo njësi paraqet cdo fund viti akademik.</i> <i>GVJ mendon se standardi përmbushet plotësisht pasi institucioni nepërmjet njërive përgjegjëse të programit monitoron përpjekjet që bëhen për realizimin e objektivave të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e	Nga shqyrtimi i Manualit të Sigurimit të Cilësisë së UNIKO dhe nga vizita në institucion mund të konfirmojmë se për garantimin procesit të sigurimit të cilësisë institucioni ka përfshirë të gjitha strukturat e

¹⁹⁷ "Të dhëna nga pyetësorët me studentët NJSBC/ SKVIA" Evidenca nr: 2.23

¹⁹⁸ "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare 2022-2023, UNIKO" Evidenca nr: 2.8

brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	brendshme të tij duke përcaktuar në manual përgjegjësitë si të Senatit akademik, NJSBC, stafi akademik dhe studentët.¹⁹⁹ Për përfshirjen e aktorëve të jashtëm në procesin e sigurimit të cilësisë UNIKO ka ngritur edhe “Bordin Këshillimor” me përfaqësues nga organet vendore dhe institucione të tjera, veprimtaria e të cilave lidhet drejtpërdrejt me rezultatet e të nxënësve të programeve të studimit si dhe me çështjet e punësimit të diplomuarve.²⁰⁰
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rezulton se në Statutin e UNIKO-së si dhe në Manualin e cilësisë, janë të përcaktuara qartë përgjegjësitë e tërë aktorëve që marrin pjesë në procesin e vlerësimit të cilësisë në institucion si të DKVIA dhe të NJSBC në nivel institucioni dhe njësisë pranë fakulteteve. Veprimtaria e këtyre strukturave konsiston në tërë procesin mësimor, me qëllim përmirësimin e treguesve të performancës apo cilësisë së programeve të studimit.²⁰¹
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Nga analiza e dokumentacionit dhe shqyrtimi i veprimtarive që organizon DKVIA dhe NJSBC në UNIKO mund të konkludojmë se në procesin e sigurimit të cilësisë të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ka një bashkëpunim me hallkat e tjera institucionale, njësitë kryesore, njësitë bazë, anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës akademik, studentët, pasqyruar kjo në diskutimet, opinionet apo sugjerimet e tyre, raportet e analizave vjetore që organizohen në shkallë fakulteti apo institucioni.²⁰²
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe verifikimit gjatë vizitës në UNIKO konstatohet se sanksionuar në aktet rregullatore dhe Kodin e Etikës të institucionit (neni 5;6;7), në procesin e përfshirjes dhe aktivizimit të stafit akademik dhe studentëve në procesin e vlerësimit, respektohen standartet dhe integriteti akademik i stafit, përsosmëria dhe liria akademike, respekti i ndërsjellë dhe dinjiteti njerëzor, duke siguruar një trajtim të barabartë të pedagogëve, studentëve dhe vartësve.²⁰³

¹⁹⁹ “Manuali i Cilësisë së UNIKO” Evidenca nr: 1.16

²⁰⁰ “Vendimi për krijimin e bordit këshillimor UNIKO” Evidenca nr: 3.1.

²⁰¹ “Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë,” Evidenca nr: 1.1.

²⁰² “Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm NJSBC, UNIKO, relacion (raporti FEF)” Evidenca nr: 2.19

²⁰³ Kodi i Etikës në UNIKO” neni 2;6; 14;16. Evidenca Nr.1.19.)

Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga verifikimi i evidencave të paraqitura gjatë vizitës në institucion rezulton se UNIKO ka bërë pjesë aktive të procesit të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë të programit Bachelor në “ Mësuesi për Arsimin Fillor” si edhe theksuam më sipër Bordin Këshillimor, me përfaqësues nga organet vendore dhe institucione të tjera, por edhe gjithë bashkëpunëtorët e përfshirë në realizimin e këtij programi studimi, institucione dhe partnerë të ndryshëm brenda dhe jashtë Shqipërisë, për të marrë ekspertizë lidhur me ecurinë e programit. ²⁰⁴			
Konkluzione	GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit VI.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se UNIKO siguron pjesëmarrjen aktive të tërë strukturave të saj dhe nxit përfshirjen e partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera për sigurimin e brëndëshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në faqen zyrtare të UNIKO janë të aksesueshme Statuti, Rregullorja e studimit, Plan i Strategjik i Zhvillimit 2022-2027, Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e UNIKO, ku janë të pasqyruara menaxhimi institucional në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë, promovimi i një kulture të vëmëndjes ndaj cilësisë,^{205/ 206} Nga vizita në institucion u konfirmua se NJSBC publikon në faqen zyrtare të UNIKO krahas veprimtarive të planifikuara edhe raportet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, <u>por mendojmë se duhet të pasqyrohen edhe raportet e viteve të fundit pasi janë deri në vitet 2021.</u>²⁰⁷

²⁰⁴ “Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale Evidenca_Nr: 3.10

²⁰⁵ “Plani i Zhvillimit Strategjik të UNIKO, 2022-2027” Evidenca Nr.1.3

²⁰⁶ “ Faqja zyrtare UNIKO <https://unkorce.edu.al>

²⁰⁷ “Faqja zyrtare UNIKO <https://unkorce.edu.al>” (Raporte të sigurimit të brëndëshëm të cilësisë NJSBC.)

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe nga vizita në UNIKO rezulton se institucioni ka të sanksionuar në Rregulloren e funksionimit dhe organizimit DKVI dhe në Statutin e UNIKO (neni 85 pika 1) detyrimin e publikimit në faqen zyrtare të institucionit të gjithë të dhënat dhe rezultateve në kuadër të vlerësimit të programeve të studimit që ajo ofron, <u>publikime të cilat në fakt duhet të jenë periodike.</u>²⁰⁸
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga shqyrtimi i Analizës vjetrore të FEF apo të Departamentit të Edukimit rezulton se procesi i vlerësimit të programeve të studimit pas relacioneve të dhëna lidhur me rezultatet e vlerësimit ka objektiva dhe prioritetet por nuk shoqërohet me një plan masash me orientim përmirësimin e mangësive kur janë të konstatuara.²⁰⁹ <u>Rekomandojmë hartimin e një plan veprimi masash për programin e studimit ku të përcaktohen qartë mangësitë dhe dobësitë e konstatuara dhe të hartohet një plan masash me afate kohore për realizimin e tyre.</u>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i rregulloreve që disponon UNIKO dhe Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, dhe veprimtarive të planifikuara dhe të realizuara nga kjo njësi, konstatohet se është siguruar ndikimi i këtyre veprimtarive për përmirësimin dhe rritjen cilësore të performancës së pedagogëve dhe studentëve dhe përmirësimin cilësor të programit të studimit.²¹⁰
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga dokumentacioni i paraqitur si dhe vizita në institucion mund të konfirmojmë se Njësia Kryesore (FEF) dhe Njësia Bazë (DE) ofrojnë informacione të nevojshme tek staf i akademik mbi arritjet, mangësitë dhe problematikat, lidhur me cilësinë e proceseve të mësimdhënies dhe punës kërkimore. Nëpërmjet organizimit të takimeve bëhet i mundur ndërgjegjësimi i stafit, për përmirësimin e treguesve cilësorë të performancës së veprimtarisë akademike dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore për një vazhdimësi të punës për sigurimin e cilësisë.
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit VI.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstaton se IAL-ja ka të sanksionuara në strukturat e saj politika, procese dhe veprimtari për sigurimin e cilësisë, harton raporte, por sugjerojmë se ato duhet të publikohen periodikisht dhe të shoqërohen me një plan veprimi për përmirësimin e mangësive të</i>

²⁰⁸ “ Statuti i Universitetit Fan.S.Noli. Korce” Evidenca nr: 1.1

²⁰⁹ Raport i analizës vjetor të veprimtarisë mësimore shkencore të DE” Evidences Nr.2.10

²¹⁰ Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FEF, 2023-2024. .Evidenca _Nr.2.9

	<u>konstatuara.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të Programit të Studimit të Ciklit të Parë në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

- 1. Eksperienca dhe Kualifikimi i Departamentit të Edukimit në UNIKO,** është një eksperiencë e gjatë dhe e konsoliduar në ofrimin e programeve të studimit në fushën e arsimit fillor;
- 2. Struktura e Programit:** Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është i strukturuar dhe funksionon sipas Ligjit për Arsimin e Lartë dhe akteve nënligjore, i orientuar drejt përmirësimit cilësor në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 3. Njohuri dhe Mundësi për Integrim në Mjedisin Kërkimor:** Ky program ofron njohuri të thelluara dhe mundësi për integrim të studentëve në mjedisin kërkimor shkencor, si në nivelin kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, siguruar nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të përbashkëta;
- 4. Praktika Profesionale dhe Përshtatja me Kërkesat e Tregut të Punës:** Programi garanton mundësi për përdorimin praktik të njohurive përmes praktikës laboratorike, praktikës profesionale dhe stazheve në bashkëpunim me Bashkitë e rajonit dhe institucione të tjera, duke ndihmuar në lidhjen e mësimit me nevojat e tregut të punës;
- 5. Politikat dhe Procedurat për Sigurimin e Cilësisë:** Politikat e ndjekura nga institucionet janë në përputhje të plotë me ligjin dhe standardet e cilësisë dhe reflektojnë një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e mësimdhënies dhe shërbimeve akademike;
- 6. Kultura e Sigurimit të Cilësisë dhe Transparenca:** Institucioni ka zhvilluar një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë, duke siguruar transparencë dhe efektivitet në të gjitha proceset e sigurisë së cilësisë dhe i ka bërë ato publike;
- 7. Infrastruktura dhe Mjediset:** Mjediset dhe infrastruktura janë të përshtatshme dhe të mirëpajisura për realizimin e procesit mësimor, duke mbështetur edhe pjesëmarrjen në projekte të financuara nga BE.

b. Pika të dobta:

1. **Përmbajtje e njëjtë në programin mësimor të disa lëndëve të përbashkëta më AP:** Përmbajtja e disa lëndëve e përbashkëta në dy programet AF dhe AP nuk janë të përshatshme me emërtimin apo me objektivat e programit mësimor për nivelin e arsimit fillor (*Standarti II.1. Kriteri 2; Standarti II.4. Kriteri 2*);
2. **Mungesa e ambienteve të përshtatshme për lëndët specifike:** Duhet të krijohen ambiente të për lëndët art figurativ dhe muzikor (*Standarti III.4. Kriteri 4*);
3. Konstatohet se disa nga syllabuset kanë literaturë e cila nuk është e përditësuar në mënyrë të vazhdueshme me botime të viteve të fundit (*Standarti II.4. Kriteri 2 dhe kriteri 5; Standarti IV.3 kriteri 1*);

Rekomandime:

1. GJVJ rekomandon që të disa nga lëndët që janë të përbashkëta me arsimin parashkollor të jenë më të thelluara me mësimdhënien në arsimin fillor;
2. GJVJ rekomandon krijimin e ambienteve të posaçme për lëndët art figurativ dhe muzikor, për të përmbushur më mirë formimin praktik dhe profesional të studentëve të programit;
3. GJVJ rekomandon përshtatjen e formatit të disa syllabuseve sipas akteve ligjore;
4. GJVJ rekomandon të ri-inkuadrohet paketa e praktikës profesionale për ta bërë atë më eficiente dhe me rezultate reale, duke integruar më shumë mundësi praktike për studentët.
5. GJVJ rekomandon Raportet e arritjeve duhet të mbështeten mbi analiza SWOT dhe duhet të kenë një strukturë të ngjashme me ato të NJSBC;
6. GJVJ rekomandon që zultatet e vlerësimit të shoqërohen me një plan masash të qartë, ku të përcaktohen mangësitë dhe dobësitë dhe të hartohet një plan masash me afate kohore për realizimin e tyre.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Primary education"

a. Strengths and affirmations:

1. **Experience and Qualifications of the Education Department at UNIKO,** is a long and consolidated experience in providing study programs in the field of primary education;
2. **Program Structure:** The Bachelor's study program in "Primary Education Teaching" is structured and operates in accordance with the Law on Higher Education and its by-laws, oriented toward quality improvement in line with national and international requirements.
3. **Knowledge and Opportunities for Integration into the Research Environment:** This program provides in-depth knowledge and opportunities for student integration into the scientific research environment, both at national and international levels, supported through joint cooperation agreements;

4. **Professional Practice and Alignment with Labor Market Demands:** The program ensures opportunities for the practical application of knowledge through laboratory work, professional internships, and placements in collaboration with regional municipalities and other institutions, supporting the connection between learning and labor market needs;
5. **Quality Assurance Policies and Procedures:** The policies followed by the institution fully comply with the law and quality standards, reflecting a continuous commitment to the improvement of teaching and academic services;
6. **Quality Assurance Culture and Transparency:** The institution has developed a clear policy for ensuring and promoting quality, ensuring transparency and effectiveness in all quality assurance processes, and has made these publicly available;
7. **Infrastructure and Facilities:** The facilities and infrastructure are adequate and well-equipped for the implementation of the teaching process, also supporting participation in EU-funded projects;

b. Weaknesses:

1. **Same content in the curriculum of some subjects common to AP:** The content of some subjects common to both the Primary education and Preschool education programs is not consistent with the name or objectives of the curriculum for the primary education level (*Standard II.1. Criterion 2; Standard II.4. Criterion 2*);
2. **Lack of suitable facilities for specific subjects:** Facilities should be created for the subjects of fine and musical arts. (*Standard III.4. Criterion 4*);
3. It is noted that some of the syllabuses is not continuously updated with publications from recent years; (*Standard II.4. Criterion 2 and criterion 5; Standard IV.3 criterion 1*)

Recommendation

1. The External evaluation group recommends that some of the subjects that are common to preschool education be more in-depth with teaching in primary education;
2. The External evaluation group recommends creating special facilities for the subjects of fine and musical arts, to better fulfill the practical and professional training of the program's students;
3. The External evaluation group recommends adapting the format of some syllabuses according to legal acts;
4. The External evaluation group recommends the professional practice component should be restructured to make it more efficient and produce real results, by integrating more practical opportunities for students.
5. The External evaluation group recommends that the Achievement Reports should be based on SWOT analyses and should have a similar structure to those of the Internal quality assurance unit;
6. The External evaluation group recommends that the results of the assessment be accompanied by a clear action plan, identifying deficiencies and weaknesses and drafting a plan of measures with deadlines for their implementation;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X